



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL**

**RAPORT
(PËRFUNDIMTAR)**

**PËR INSPEKTIMIN E KRYER NË LIDHJE ME ZBATIMIN E LIGJSHMËRISË NË
ADMINISTRIMIN E SHËRBIMIT CIVIL**

KËSHILLI I QARKUT FIER

Tiranë, Nëntor 2015

RAPORT

Për kryerjen e inspektimit në lidhje me procesin e ristrukturimit të institucionit Këshilli i Qarkut Fier.

Hyrje

Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, në mbështjete të nenit 11, pika 1, si dhe të nenit 14, pikat 1 e 2 të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar, me Vendimin e tij nr. 68, datë 02.07.2015, “*Për kryerjen e inspektimit në lidhje me zbatimin e ligjit në administrimin e shërbimit civil, si dhe në lidhje me procesin e ristrukturimit të institucionit, Këshillit të Qarkut Fier*”, ka vendosur kryerjen e inspektimit të përgjithshëm në këtë institucion për verifikimin e gjendjes së ligjshmërisë në gjithë institutet e ligjit, duke nisur nga kuptimi dhe zbatimi i drejtë i ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar; plotësimi i kushteve ligjore të statusit të punësimit, të parashikuara në nenin 67 të ligjit të sipërcituar; lëvizja, transferimi apo lirimi nga shërbimi civil i punonjësve, përputhjen e përskrimeve të reja të punës me modelin e parashikuar nga ligji, si dhe plotësimin e kërkesave të përgjithshme e të veçanta të pozicioneve të punës nga punonjësit e mbajtur pas ristrukturimit, si dhe institute të tjera që janë pjesë e ligjit që rregullon shërbimin civil.

Në zbatim të vendimit nr. 68, datë 02.07.2015, “*Për kryerjen e inspektimit në lidhje me zbatimin e ligjit në administrimin e shërbimit civil, si dhe në lidhje me procesin e ristrukturimit të institucionit, Këshillit të Qarkut Fier*”, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, inspektimi filloi në institucion në datën 20.07.2015, sipas programit të inspektimit dhe njoftimit të dërguar në subjekt, me shkresën nr.484/2 prot., datë 02.07.2015, “*Njoftim për fillimin e inspektimit të përgjithshëm në lidhje me zbatimin e ligjit në administrimin e shërbimit civil dhe procesin e ristrukturimit të administratës së Këshillit të Qarkut Fier*”.

Grupi i inspektimit, i përbërë nga inspektorët Zamira Mujali dhe Matilda Idrizaj, nën drejtimin teknik të Drejtorit të Inspektimit dhe Hetimit Administrativ, Ilia Kukumi, vijoi procesin me komunikimin me institucionin nëpërmjet të gjitha rrugëve ligjore (*me postë, komunikim elektronik dhe vizitave në subjekt*) dhe, pasi grumbulloi të dhënat dhe dokumentacionin e nevojshëm, inspektimi kaloi në fazën e përpunimit të tyre dhe hartimit të projektraportit, i cili me shkresën 484/4, datë 04.11.2015, iu dërgua për njohje subjektit të inspektimit, me qëllim që të mundësohej e drejta e vërejtjeve, në lidhje me parregullsitë e konstatuara në material.

Pas kësaj, projektraporti është kthyer i nënshkruar nga titullari i institucionit dhe nëpunësi përgjegjës për administrimin e shërbimit civil, me shkresën nr. 747/2, datë 18.11.2015, në të cilën ata janë shprehur dakort me përmbajtjen e këtij materiali.

Në këto rrethana, rezulton të jenë kryer të gjitha procedurat e nevojshme për të siguruar transparencën e procesit si dhe mundësinë e institucionit për të shprehur pretendimet e tij në lidhje me problemet e evidentuara.

Qëllimi i inspektimit:

- Monitorimi, kontrolli dhe vlerësimi i zbatimit të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*” (i ndryshuar) dhe akteve nënligjore të dala në bazë e për zbatim të tij.
- Paralajmërimin e institucionit dhe personave përgjegjës, në rast të konstatimit të parregullsive gjatë zbatimit të ligjit, duke lënë detyrat dhe rekomandimet përkatëse për përmirësimin e situatës, brenda një afati të arsyeshëm, sipas përcaktimeve të bëra në nenin 15, të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, (i ndryshuar).

Objekti i inspektimit:

1. Si është kuptuar dhe zbatuar ligji nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, (i ndryshuar) dhe aktet nënligjore të dala në bazë dhe për zbatim të tij, në lidhje me statusin e nëpunësve dhe punonjësve aktualë të institucionit në momentin e fillimit të efekteve të ligjit.
2. Plotësimi i kushteve ligjore të parashikuara në nenin 67, të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*” (i ndryshuar), në lidhje me statusin e punonjësve dhe nëpunësve aktualë, që do të verifikohet në këto aspekte:
 - Përfshirja e funksionit në shërbimin civil në përputhje me përshkrimin e punës dhe detyrat që realizon ky funksion;
 - Punonjësit ekzistues që janë punësuar në pozicione të shërbimit civil sipas këtij ligji, që janë rekrutuar sipas një procedure pranimit konkurruese, nëpërmjet procedurave të ngjashme me dispozitat e ligjit të mëparshëm, nr. 8549, dt.11.11.1999, “*Statusi i nëpunësit Civil*”, apo për një periudhë jo më të vogël se 1 vit;
 - Nëpunësit ekzistues që janë të punësuar në pozicione, pjesë të shërbimit civil, sipas këtij ligji, pa kaluar më parë në procedurë formale konkurruese ose që kanë më pak se një vit në këto pozicione pune;
 - Rastet e refuzimit të deklaramit të statusit të nëpunësit civil;
 - Si është dokumentuar procedura e ndjekur nga njësia përgjegjëse, në rastin e deklaramit të statusit të punësimit të punonjësve.
Si është dokumentuar në dosjen e personelit procedura e verifikimit dhe akti i deklaramit të statusit të punësimit nga njësia përgjegjëse, kërkesat e përgjithshme, kërkesat e posaçme, procedura e rekrutimit, akti i emërimit, etj.
3. Respektimi i kërkesave ligjore në hartimin e formularit të përshkrimit të punës sipas formatit të përcaktuar nga ligji për nëpunësin civil dhe aktet nënligjore që kanë dalë në zbatim të tij, që do të verifikohet në këto aspekte:
 - Si është zbatuar procedura e hartimit të përshkrimit të pozicioneve të punës sipas formatit të miratuar me aktin nënligjor përkatës.
 - Nëpunësit që janë të emëruar aktualisht në pozicione pune pjesë e shërbimit civil, i plotësojnë ose jo, kërkesat e përgjithshme të përcaktuara në nenin 21, të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, (i ndryshuar).

4. Procedura e ndjekur nga institucioni në lidhje me miratimin e planit vjetor të pranimit në shërbimin civil.
5. Rastet e rekrutimeve, lëvizjes paralele dhe ngritjes në detyrë, pas momentit të fillimit të efekteve juridike të ligjit nr. 152/2013, "Për nëpunësit civil", (i ndryshuar).
6. Respektimi i kërkesave specifike ligjore, gjatë procesit të përmbushjes së periudhës së provës (*detyrimet e nëpunësit dhe institucionit dhe procedura e vendimmarrjes në përfundim të kësaj periudhe*).
7. Transferimi i përkohshëm dhe i përhershëm, si janë respektuar kërkesat ligjore në këto raste (*ristrukturimi dhe ngritja e komisionit përkatës, aktet që materializojnë procesin, si dhe rastet e tjera të transferimit*).
8. Pezullimi nga shërbimi civil, sipas rasteve të parashikuara në ligj dhe si janë zbatuar kërkesat ligjore gjatë procedurës së zhvilluar në këto raste.
9. Masat disiplinore dhe respektimi i procedurës ligjore të kërkuar në fazat e zhvillimit të ecurisë disiplinore (*kërkesa për fillimin e ecurisë, ngritja e Komisionit të Përhershëm të Disiplinës*).
10. Përfundimi i marrëdhënies në shërbimin civil për shkak të lirimit nga shërbimi civil, si rezultat i dorëheqjes dhe për shkak të ligjit.
11. Probleme të ndryshme që i kanë lindur njësisë së menaxhimit të burimeve njerëzore, gjatë punës për zbatimin e ligjit nr. 152/2013, "Për nëpunësin civil", (i ndryshuar).

Metodologjia e inspektimit:

Në zbatim të programit dhe drejtimeve të inspektimit, grupi i punës verifikoi dhe shqyrtoi dokumentacionin nëpërmjet këqyrjes së materialeve të administruara në dosjet e personelit dhe në arkivën e institucionit.

- U verifikuan të gjitha pozicionet e punës që janë pjesë e shërbimit civil, sipas organigramës dhe strukturës së institucionit;
- U verifikuan procedurat e rekrutimit dhe përmbajtja e dosjeve individuale të çdo nëpunësi civil, si dhe çdo e dhënë tjetër, kërkuar nga ligji për plotësimin e kërkesave të përgjithshme për pranimin në shërbimin civil;
- U verifikua nëse përshkrimet edhe vlerësimet individuale të punës për pozicionet pjesë të shërbimit civil, janë të hartuara në përputhje me formatin standard të miratuar;
- Të dhënat profesionale si dhe të dhënat e tjera për marrëdhëniet e punës të çdo nëpunësi civil, lidhur me përmbushjen e kërkesave të posaçme të vendit të punës si arsimi, përvoja në punë e të tjera;
- Aktet që materializojnë ndryshimet strukturore:

- Vendimi nr. 2 datë 24.04.2012 “Për miratimin e strukturës organizative të Administratës së Këshillit të Qarkut Fier”;
- Urdhër nr. 11/1, datë 11.11.2013, i Kryetarit të Këshillit të Qarkut Fier, për ngritjen e komisionit *ad-hoc*;
- Urdhër nr. 41, datë 27.12.2013, i Kryetarit të Këshillit të Qarkut Fier, për nisjen e procedurave të njoftimeve të vendeve të lira të punës;
- Vendim nr. 4, dt.07.02.2014, i kryetarit të Këshillit të Qarkut Fier, për miratimin e strukturës organizative të administratës së Këshillit të Qarkut Fier;
- Vendim nr. 8, dt.07.02.2014, i kryetarit të Këshillit të Qarkut Fier, për caktimin e numrit të punonjësve të Seksionit të Administrimit dhe Mbrojtjes së Tokës;
- Rregullore nr. 90/7 prot., dt.07.02.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e administratës së Këshillit të Qarkut Fier”;
- Urdhër nr. 43, datë 01.04.2014, i Kryetarit të Këshillit të Qarkut Fier, për ngritjen e Komisionit Disiplinor;
- Urdhër nr. 53, datë 24.04.2014, i Kryetarit të Këshillit të Qarkut Fier, për ngritjen e Komitetit të Përhershëm të Pranimit;
- Vendimi nr. 2, datë 15.01.2015, i Kryetarit të Këshillit të Qarkut Fier, për miratimin e strukturës organizative të administratës së Këshillit të Qarkut Fier për vitin 2015;
- Urdhër nr. 4, datë 02.02.2015, për ngritjen e Komisionit të Ristrukturimit;
- Procesverbal nr.1;
- Propozim i Drejtorisë së Menaxhimit të Burimeve Njerëzore pranë Qarkut Fier;
- Rregullore nr.510/1 prot., dt.04.05.2015, “Për organizimin dhe funksionimin e administratës së Këshillit të Qarkut Fier”;
- Vendimi nr. 37, datë 01.06.2015, i Kryetarit të Këshillit të Qarkut Fier, për miratimin e strukturës organizative të administratës së Këshillit të Qarkut Fier për vitin 2015;
- Listëpagesat e muajit shkurt - mars 2014, për të gjithë punonjësit e institucionit;
- Listëpagesat e muajit maj 2015 për të gjithë punonjësit e institucionit.

Përmbajtja e raportit:

I. Deklarimi i statusit të punësimit dhe si janë respektuar kërkesat e nenit 67 të ligjit nr.152/2013, “Për nëpunësin civil” (i ndryshuar) dhe akteve nënligjore në zbatim të tij.

1. Strukturimi i institucionit dhe ndarja e pozicioneve të punës në momentin e inspektimit.

Ligji nr.152/2013, “Për nëpunësin civil i ndryshuar, ka përcaktuar rregullat e administrimit të shërbimit civil, për institucionet që hyjnë në fushën e veprimit të tij.

Në nenin 2 të këtij ligji, përcaktohet se subjekt i tij është çdo nëpunës që ushtron një funksion publik në një institucion të administratës shtetërore, institucion të pavarur apo njësi të qeverisjes vendore.

Këshilli i Qarkut Fier, është krijuar dhe funksionon si organ përfaqësues i Qarkut, mbi bazën e ligjit nr. 8652, datë 31.07.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore”,

ndryshuar me ligjin nr. 9208, datë 18.03.2004, i cili në nenet 5 dhe 6 të tij, e përcakton atë si njësi të qeverisjes vendore e për këtë arsye, ky institucion përfshihet në fushën e veprimit të ligjit për nëpunësin civil.

Administrata e Këshillit të Qarkut Fier funksionon mbi bazën e strukturës organizative të miratuar nga Këshilli i Qarkut, sipas parashikimeve të nenit 54, të ligjit nr. 8652, datë 31.07.2000, *“Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore”*, ku përcaktohen detyrat dhe kompetencat e Këshillit të Qarkut.

Aktualisht, subjekti i inspektimit, funksionon sipas strukturës organizative të miratuar me Vendimin nr. 37, datë 01.06.2015, *“Për miratimin e ndryshimit të strukturës organizative të administratës së Këshillit të Qarkut Fier të vitit 2015”*, ndërsa në momentin e fillimit të efekteve juridike të ligjit nr. 152/2013, *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar, Këshilli i Qarkut Fier ka funksionuar sipas strukturës organizative të miratuar me Vendimin nr. 4, datë 07.02.2014 të Këshillit të Qarkut, *“Për miratimin e strukturës organizative të Administratës së Këshillit të Qarkut Fier për vitin 2014”*.

Duke patur parasysh klasifikimin e pozicioneve të punës pjesë e shërbimit civil, sipas përcaktimeve të nenit 19, të ligjit nr. 152/2013, *“Për nëpunësin civil”* (i ndryshuar), si dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.142, datë 12.03.2014, *“Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura”*, sipas strukturës aktuale, rezulton se administrata e Këshillit të Qarkut Fier ka gjithsej **25** pozicione pune, nga të cilat **9** pozicione pune janë të nivelit administrativ (*mbështetëse*) dhe marrëdhëniet e punës rregullohen sipas Kodit të Punës së Republikës së Shqipërisë, ndërsa **16** pozicione pune janë pjesë e shërbimit civil dhe ndahen në këto kategori:

- Nëpunës civilë të nivelit të mesëm drejtues, rezulton të jenë **3** pozicione pune, që i përkasin nivelit *“Drejtor Drejtorie”*;
- Nëpunës civilë të nivelit të ulët drejtues, rezulton të jenë **2** pozicione pune, që i përkasin nivelit *“Përgjegjës sektori”*;
- Nëpunës civilë të nivelit ekzekutiv janë **11** pozicione pune, të cilat i përkasin nivelit *“specialist/inspektor”*.

Gjithashtu, në përbërje të Këshillit të Qarkut Fier është edhe Drejtorja e Administrimit dhe Mbrojtjes së Tokës (DAMT), e cila është funksion i deleguar prej Ministrisë së Bujqësisë. Kjo drejtori ka gjithsej 8 pozicione pune pjesë e shërbimit civil, ndarë në këto kategori:

- Nëpunës civilë të nivelit të mesëm drejtues, rezulton të jetë **1** pozicion pune, që i përket nivelit *“Drejtor Drejtorie”*;
- Nëpunës civilë të nivelit të ulët drejtues janë **3** pozicione pune, të cilat i përkasin nivelit *“Përgjegjës Sektori”*;
- Nëpunës civilë të nivelit ekzekutiv janë **4** pozicione pune, të cilat i përkasin nivelit *“specialist”*.

Konkluzion: Nisur nga funksionet e çdo pozicioni pune që është përfshirë në shërbimin civil, duke u bazuar në Rregulloren e institucionit, konstatohet se në lidhje me metodologjinë e ndjekur

për klasifikimin e pozicioneve të punës në këtë institucion, është ruajtur një raport i drejtë midis pozicioneve të punës që janë pjesë e shërbimit civil, nga ato që kryejnë funksione administrative.

2. Si është kuptuar dhe zbatuar neni 67, i ligjit nr.152/2013, "Për nëpunësin civil", i ndryshuar dhe aktet nënligjore në zbatim të tij.

Nisur nga fakti që subjekti i inspektuar është pjesë e shërbimit civil, deklarimi i statusit të punësimit për çdo nëpunës në pozicione pune, pjesë e shërbimit civil, duhet të bëhet në respektim të kërkesave të përcaktuara në nenin 67, pikat 3, 4 dhe 6, të ligjit nr. 152/2013, "Për nëpunësin civil", i ndryshuar, ku përcaktohet në mënyrë të shprehur se:

- pika 3, "Nëpunësit civilë ekzistues, punonjësit ekzistues, që janë të punësuar në pozicione të shërbimit civil, sipas këtij ligji dhe që janë rekrutuar sipas një procedure pranimi konkurruese, të ngjashme me atë të përcaktuar nga ligji nr.8549, datë 11.11.1999, "Statusi nëpunësit civil", apo që janë të punësuar në të njëjtin vend pune për një periudhë jo më të vogël se 1 vit, janë, për shkak të ligjit, nëpunës civilë";
- pika 4, "Nëpunës ekzistues, që janë të punësuar në pozicione pune, pjesë e shërbimit civil sipas këtij ligji dhe që nuk plotësojnë kushtet e parashikuara në pikën 3 të këtij neni, janë nëpunës civilë në periudhë prove dhe për ta zbatohen dispozitat e nenit 24 të këtij ligji. Periudha e provës fillon nga fillimi i shtrirjes së efekteve të këtij ligji";
- pika 6, Deklarimi i statusit të punësimit, sipas pikave 1, 3 dhe 4 të këtij neni, bëhet nga njësia përgjegjëse pas verifikimit të procedurës së punësimit".

Po kështu, në Vendimin nr. 116, datë 05.03.2014, të Këshillit të Ministrave, "Për statusin e nëpunësve dhe punonjësve aktualë që përfitojnë statusin e nëpunësit civil sipas ligjit nr.152/2013, "Për nëpunësin civil", i ndryshuar, Kreu II, "Statusi i nëpunësve të tjerë civilë në institucionet e administratës shtetërore, institucionet e pavarura, bashkitë dhe qarqet", pika 1, është përcaktuar se: "Nëpunës civilë", sipas pikës 3 të nenit 67, janë të gjithë ata nëpunës që kryejnë funksione të shërbimit civil në momentin e fillimit të efekteve të ligjit nr.152/2013 dhe që janë rekrutuar sipas procedurave konkurruese, përcaktuar nga ligji nr. 8549, datë 11.11.1999, "Statusi i nëpunësit civil".

Këto janë dispozitat bazë që duhet të mbajë parasysh njësia përgjegjëse për të realizuar drejt detyrimin ligjor të deklarimit të statusit të punësimit.

Për të arritur në një konkluzion të saktë lidhur me veprimet e kryera nga njësia e burimeve njerëzore, si njësi përgjegjëse për administrimin e shërbimit civil, grupi i inspektimit këqyri në subjekt dokumentacionin e administruar në dosjen personale të nëpunësve dhe analizoi aktet administrative që përmbajnë të dhëna lidhur me pozicionet pjesë e shërbimit civil, si dhe organigramën e strukturën analitike të institucionit.

Me këtë rast duhet të theksojmë se, megjithëse momenti i fillimit të efekteve juridike të ligjit (dt.26.02.2014) e gjeti institucionin e Këshillit të Qarkut Fier me një strukturë të miratuar me Vendimin nr. 4, datë 07.02.2014, të Këshillit të Qarkut Fier, "Për miratimin e strukturës organizative të Administratës së Këshillit të Qarkut Fier për vitin 2014", ajo filloi implementimin në datën 01.03.2014.

Sipas strukturës në fjalë, administrata e institucionit përbëhej nga **61** pozicione pune dhe duke patur parasysh klasifikimin e pozicioneve në shërbimit civil, sipas përcaktimeve të nenit 19, të Ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, (i ndryshuar), rezulton se **48** prej tyre, janë pozicione pune pjesë e shërbimit civil dhe ndahen në këto kategori:

- Nëpunës civilë të nivelit të mesëm drejtues janë **11** pozicione pune, të cilat i përkasin pozicionit “*Drejtor Drejtorie*” dhe “*Kryeinspektor*”.
- Nëpunës civilë të nivelit të ulët drejtues janë **1** pozicion pune, i cili i përket pozicionit “*Përgjegjës sektori*”.
- Nëpunës civilë të nivelit ekzekutiv janë **36** pozicione pune, të cilat i përkasin pozicionit “*Specialist*”.

Pas zbatimit të strukturës në fjalë, gjendja e statusit të punësimit të punonjësve të mbetur në detyrë, paraqitet si më poshtë:

a. Nëpunës, të cilëve u është deklaruar statusi i punësimit në kategorinë e nëpunësve civilë të konfirmuar.

Gjendja e statusit të punësimit, në momentin e fillimit të efekteve juridike të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil” (i ndryshuar), për punonjësit që kanë fituar statusin e nëpunësit civil, të konfirmuar sipas kërkesave të pikës 3 të nenit 67, të ligjit nr.152/2013, “Për nëpunësin civil”(i ndryshuar), si dhe pikës 1, të Vendimit nr. 116, datë 05.03.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për statusin e nëpunësve dhe punonjësve aktualë që përfitojnë statusin e nëpunësit civil sipas ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil” (i ndryshuar), Kreu II, “Statusi i nëpunësve të tjerë civilë në institucionet e administratës shtetërore, institucionet e pavarura, bashkitë dhe qarqet”, ka qënë si më poshtë:

1. ***** , në pozicionin e punës “*Specialist në Drejtorinë e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore*”;
2. ***** , në pozicionin e punës “*Specialist në Drejtorinë e Programim Zhvillimit*”;
3. ***** , në pozicionin e punës “*Specialist në Drejtorinë e Programim Zhvillimit*”;
4. ***** , në pozicionin e punës “*Specialist në Drejtorinë e Programim Zhvillimit*”;
5. ***** , në pozicionin e punës “*Specialist në Drejtorinë e Mjedisit*”;
6. ***** , në pozicionin e punës “*Specialist në Drejtorinë e Mjedisit*”;
7. ***** , në pozicionin e punës “*Drejtor i Drejtorisë së Turizmit dhe Kulturës*”;
8. ***** , në pozicionin e punës “*Specialist në Drejtorinë e Turizmit dhe Kulturës*”;
9. ***** , në pozicionin e punës “*Specialist në Drejtorinë e Turizmit dhe Kulturës*”;
10. ***** , në pozicionin e punës “*Specialist në Drejtorinë e Turizmit dhe Kulturës*”;
11. ***** , në pozicionin e punës “*Specialist në Drejtorinë e Shërbimeve Rajonale*”;
12. ***** , në pozicionin e punës “*Specialist në Drejtorinë e Shërbimeve Rajonale*”;
13. ***** , në pozicionin e punës “*Drejtor në Drejtorinë e Planifikimit dhe Kontrollit Urban*”;
14. ***** , në pozicionin e punës “*Specialist në Drejtorinë e Planifikimit dhe Kontrollit Urban*”;
15. ***** , në pozicionin e punës “*Specialist në Drejtorinë e Planifikimit dhe Kontrollit Urban*”;

16. *****, në pozicionin e punës “*Specialist në Drejtorinë e Planifikimit dhe Kontrollit Urban*”;
17. *****, në pozicionin e punës “*Inspektor për auditimin e rrugëve*”, në Drejtorinë e Planifikimit dhe Kontrollit Urban
18. *****, në pozicionin e punës “*Jurist në Drejtorinë e INU*”;
19. *****, në pozicionin e punës “*Specialist në Drejtorinë e Financës*”
20. *****, në pozicionin e punës “*Specialist në Drejtorinë Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë*”;
21. *****, në pozicionin e punës “*Specialist në Drejtorinë e Përkujdesjes Sociale*”;
22. *****, në pozicionin e punës “*Specialist në Drejtorinë e Përkujdesjes Sociale*”;
23. *****, në pozicionin e punës “*K/inspektor i Inspektoriatit të Mbrojtjes së Tokës*”;
24. *****, në pozicionin e punës “*Jurist në Inspektoriatin e Mbrojtjes së Tokës*”;
25. *****, në pozicionin e punës “*Përgjegjës*” në zyrën e Administrimit dhe Mbrojtjes së Tokës për Lushnjën;
26. *****, në pozicionin e punës “*Specialist në Drejtorinë e Administrimit dhe Mbrojtjes së Tokës*”, zyra Lushnje;
27. *****, në pozicionin e punës “*Specialist në Drejtorinë e Administrimit dhe Mbrojtjes së Tokës*”, zyra Lushnje ;
28. *****, në pozicionin e punës “*Specialist në Drejtorinë e Administrimit dhe Mbrojtjes së Tokës*”, zyra Fier;
29. *****, në pozicionin e punës “*Përgjegjës*” në Drejtorinë e Administrimit dhe Mbrojtjes së Tokës për Mallakastrën;
30. *****, në pozicionin e punës “*Specialist në Drejtorinë e Administrimit dhe Mbrojtjes së Tokës*”, zyra Mallakastër;

Nga përmbajtja e akteve të emërimit, të punonjësve të mësipërm, ku përfshihet momenti i fillimit të marrëdhënieve të punës dhe atyre financiare, rezultojnë se këta punonjës, në momentin e fillimit të efekteve të ligjit nr. 152/2013 “*Për nëpunësin civil*”, (i ndryshuar) kanë qenë në detyrë për një periudhë më shumë se një vit, prandaj statusi i punësimit të tyre është deklaruar “*Nëpunës civil*”. Për këta punonjës, në mënyrë të hollësishme, të dhënat që kanë lidhje me marrëdhënien e tyre të punësimit, janë të parashikuara në ankesin nr. 1, që bën fjalë për aktet administrative që materializojnë procesin e deklarimit të statusit të punësimit në këtë institucion, që është edhe pjesë e këtij raporti.

Konkluzion. Për të gjitha sa analizuam me sipër, Komisioneri vlerëson se njësia përgjegjëse, ka vepruar drejt në rastin e konfirmimit të statusit të punësimit si nëpunësi civil, për punonjësit e mësipërm, për të cilët në mënyrë të hollësishme, të dhënat që kanë lidhje me marrëdhënien e punësimit, janë të parashikuara në ankesin nr. 1, që bën fjalë për aktet administrative që materializojnë procesin e deklarimit të statusit të punësimit në këtë institucion, që është edhe pjesë e këtij raporti.

b. Nëpunës, të cilëve u është deklaruar statusi i punësimit në kategorinë e nëpunësve civilë në periudhë prove.

Në disa raste, nëpunësit ekzistues janë punësuar në pozicione pjesë të shërbimit civil, por nuk plotësojnë kushtet e parashikuara në nenin 67, pika 3, të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin*

civil”, i ndryshuar, për shkak se në momentin e fillimit të efekteve të ligjit të ri të shërbimit civil, kishin një periudhë më pak se një vit në atë pozicion pune. Drejtoria e Burimeve Njerëzore, sipas përcaktimeve të nenit 67, pika 4, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, ka nxjerrë aktin e deklarimit të statusit të punësimit si nëpunës civilë në periudhë prove për gjithë këto raste.

Punonjësit që kanë përfituar statusin e nëpunësit civil në periudhë prove në këtë kategori janë:

1. *****, në pozicionin e punës “Drejtor në Drejtorinë e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore”;
2. *****, në pozicionin e punës “Specialist në Drejtorinë e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore”;
3. *****, në pozicionin e punës “Specialist në Drejtorinë e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore”;
4. *****, në pozicionin e punës “Drejtor në Drejtorinë e Programim Zhvillimit”;
5. *****, në pozicionin e punës “Drejtor në Drejtorinë e Mjedisit”;
6. *****, në pozicionin e punës “Specialist në Drejtorinë e Mjedisit”;
7. *****, në pozicionin e punës “Drejtor në Drejtorinë e Shërbimeve Rajonale”;
8. *****, në pozicionin e punës “Jurist në Drejtorinë e Urbanistikës”;
9. *****, në pozicionin e punës “Specialiste në Drejtorinë e INU”;
10. *****, në pozicionin e punës “Drejtor në Drejtorinë e Financës”;
11. *****, në pozicionin e punës “Specialist në Drejtorinë e Financës”;
12. *****, në pozicionin e punës “Drejtor në Drejtorinë Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë”
13. *****, në pozicionin e punës “Specialist në Drejtorinë Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë”;
14. *****, në pozicionin e punës “Kordinator në Lushnje”, në Drejtorinë Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë;
15. *****, në pozicionin e punës “Kordinator në Mallakastër”;
16. *****, në pozicionin e punës “Inspektor i Inspektoriatit të Mbrojtjes së Tokës”;
17. *****, në pozicionin e punës “Drejtor në Drejtorinë e Administrimit dhe Mbrojtjes së Tokës”;
18. *****, në pozicionin e punës “Specialist i Zyrës Fier”, në Drejtorinë e Administrimit dhe Mbrojtjes së Tokës

Nga përmbajtja e akteve të emërimit, ku përfshihet momenti i fillimit të marrëdhënieve të punës dhe atyre financiare, rezulton se këta punonjës kanë më pak se një vit që e kryejnë detyrën e tyre funksionale në pozicionet në të cilat janë deklaruar si nëpunës civilë në periudhë prove, për të cilët, në mënyrë të hollësishme, të dhënat që kanë lidhje me marrëdhënien e punësimit, janë të parashikuara në ankesin nr. 1, që bën fjalë për aktet administrative që materializojnë procesin e deklarimit të statusit të punësimit në këtë institucion, që është edhe pjesë e këtij raporti.

Konkluzion: Komisioneri vlerëson se, Drejtoria e Burimeve Njerëzore, si njësi përgjegjëse, e ngarkuar nga ligji për të formalizuar aktin e deklarimit të statusit, ka vepruar sipas përcaktimeve

të pikave 3, 4 dhe 6 të nenit 67, të ligjit nr.152/2013, "Për nëpunësin civil", (i ndryshuar), si dhe pikës 1 të Vendimit nr. 116, datë 05.03.2014, të Këshillit të Ministrave, "Për statusin e nëpunësve dhe punonjësve aktualë që përfitojnë statusin e nëpunësit civil sipas ligjit nr. 152/2013, "Për nëpunësin civil", Kreu II "Statusi i nëpunësve të tjerë civilë në institucionet e administratës shtetërore, institucionet e pavarura, bashkitë dhe qarqet", në momentin kur ka nxjerrë aktin e deklarimit të statusit të punësimit si nëpunës civilë në periudhë prove për këto raste.

- Në këtë moment do të veçojmë rastin e punonjësës ***** , nëpunëse civile në pozicionin "Inspektor i Inspektoriatit të Mbrojtjes së Tokës", që u hetua në mënyrë analitike, për shkak të specifikave të konstatuara, të cilat do t'i analizojmë më poshtë me hollësi.

Nga verifikimi i dosjes së personelit në këtë rast, të binte në sy fakti se njësia e personelit, i kishte ndërprerë marrëdhënien e punës për shkak moskonfirmimi në fund të periudhës së provës, në një kohë që ajo ishte vlerësuar me nivelin "Mirë"(2). Nga ana tjetër, sipas akteve të këqyrura, rezulton se kjo punonjëse nuk është liruar për shkak ristrukturimit, në një kohë që kishte ndodhur një proces i tillë, por ishte liruar për shkak moskonfirmimi; më pas, kur është krijuar një pozicion i lirë, rezulton se është rifitur në konkurrim për këtë pozicion ("Inspektor i Inspektoriatit të Mbrojtjes së Tokës") dhe pasi ka fituar, është kategorizuar përsëri si punonjëse në periudhë prove, në një kohë që ajo duhej të ishte efektive në listë pritje dhe nuk ishte e nevojshme të bënte përsëri konkurrim e për më tepër të kryente edhe një herë periudhën e provës, etj. Pas shqyrtimit të materialeve shkresore të dosjes së personelit dhe pasi u kryen verifikimet e nevojshme, rasti përshkruhet si më poshtë:

Punonjësja ***** , ka filluar punë për herë të parë në Këshillin e Qarkut Fier, me aktin e emërimit nr. 38/1, dt. 16.12.2013, në pozicionin "Specialiste në Inspektoriatin e Mbrojtjes së Tokës - IMT". Më pas, është kryer procedura e konkurrimit, ku ajo është shpallur fituese dhe me aktin nr. 38/3, dt. 08.01.2014, është emëruar nëpunëse civile në periudhë prove në pozicionin "specialiste në IMT".

Pas disa kohësh, duke qenë akoma me statusin e nëpunësit civil në provë në këtë pozicion, me vendimin nr. 16, dt. 17.03.2014, pa ndonjë arsye të përshkruar, është transferuar në pozicionin "Specialiste në Drejtorinë e Shërbimeve Rajonale".

Me fillimin e efekteve të ligjit nr 152/2013, "Për nëpunësin civil" (i ndryshuar), nga ana e njësisë së burimeve njerëzore, me aktin nr.480/1/33, dt. 08.05.2014, është deklaruar statusi i punësimit, nëpunëse civile në periudhë prove, në këtë pozicion.

Me plotësimin e periudhës së provës dhe pasi ka kryer trajnimin e detyrueshëm pranë Shkollës së Administratës Publike (ASPA), nga ana e eprorit direkt është bërë vlerësimi i arritjeve vjetore dhe prej tij, është arritur në përfundimin se puna e saj vlerësohet: "Mirë"(2).

Rezultoni se ky vlerësim është konfirmuar sipas rregullit nga zyrtarët përkatës. Megjithatë, pas disa ditësh, në kundërshtim me vlerësimin e mësipërm, drejtuesi i institucionit (që në rastin e vlerësimit paraqitej si Zyrtari Autorizues), me aktin nr. 154/1 dt. 10.02.2015 ka vendosur "Moskonfirmimin si nëpunës civil" të punonjësës ***** dhe mbi këtë bazë, me aktin nr. 18, dt.02.03.2015, është urdhëruar largimi i saj nga shërbimi civil.

Ndërkaq, në dosjen e personelit, ekzistonte edhe një “Njoftim” me nr. 93/1, prot., dt. 02.02.2015, “Për suprimimin e vendit të punës”, njoftim ky që është bërë vetëm pak ditë para marrjes së vendimit të moskonfirmimit si nëpunëse civile dhe lirimit nga shërbimi civil.

Pas disa muajsh, kjo punonjëse ka marrë pjesë përsëri në një konkurrim të hapur për pozicionin vakant “Specialiste e INU në Drejtorinë e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore” pranë Këshillit të Qarkut Fier dhe pasi ka dalë fituese, me Vendimin nr. 52, dt. 02.10.2015, është emëruar nëpunëse civile në periudhë prove. Aktualisht kjo punonjëse vijon periudhën e provës në pozicionin e mësipërm.

Duke analizuar gjithë historinë e ecurisë së zhvillimit të procesit të menaxhimit të këtij rasti, nga njësia e burimeve njerëzore, rezulton se nga ana e saj nuk ka një kuptim të drejtë të instituteve të ndryshme të shërbimit civil dhe nuk ka një zbatim të tyre në përputhje me ligjin.

Gjithashtu, vërehet se prej kësaj njësie, nuk është dhënë këshillimi i duhur në organin drejtues të institucionit, duke u bërë shkak për dhënien e vendimeve të pabazuara dhe për një trajtim të padrejtë të rastit, gjë e cila ka sjellë parregullsi në menaxhimin e burimeve njerëzore.

Së pari, është e padrejtë që njësia e burimeve njerëzore, të lejonte që, në kushtet e një vlerësimi pozitiv, “Mirë” (2), të dalë vendimi për moskonfirmimin e nëpunësit në fund të periudhës së provës dhe për këtë shkak të urdhërohet lirimi nga shërbimi civil. Për më tepër, pak ditë para vendimit të moskonfirmimit, ka një njoftim zyrtar që bën fjalë për faktin se pas miratimit të strukturës së re, me Vendimin nr. 2, dt. 15.01.2015, të Kryetarit të Këshillit të Qarkut Fier, në kuadër të ristrukturimit, ka shkurtim të pozicionit të punës “Specialiste në Drejtorinë e Shërbimeve Rajonale”. Duke renditur faktet e mësipërme dhe analizuar këtë situatë në formë e në përmbajtje, krijohet përshtypja se, vendimi i pabazuar i moskonfirmimit është një “lëvizje” në mashtrim të ligjit, për të mos lejuar funksionimin e atyre instituteve që janë ngritur për mbrojtjen e nëpunësit civil dhe evituar ato pasoja financiare që parashikon ligji nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil” (i ndryshuar) në përpjekje për të zbutur sadopak impaktin që krijojnë rastet e transferimeve për shkak të shkurtimit të vendeve të punës.

Së dyti, në trajtimin e rastit në fjalë, njësia e burimeve njerëzore ka gabuar duke shkelur nenet 48 dhe 49, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil” (i ndryshuar) dhe pikën 3, Kreu I, të VKM nr.171, dt. 26.03.2014, “Për transferimin e përhershëm dhe të përkohshëm të nëpunësve civilë, pezullimin dhe lirimin nga shërbimi civil”, kur ka lejuar transferimin e nëpunëses ***** me Vendimin nr. 16, dt. 17.03.2014, nga pozicioni “Specialiste e INU në Drejtorinë e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore”, në pozicionin “Specialiste në Drejtorinë e Shërbimeve Rajonale”, në një kohë që kjo punonjëse ishte në periudhë prove. Ky veprim ka sjellë si pasojë që, ristrukturimi e ka gjetur punonjësen në një pozicion pune të ndryshëm nga ai për të cilin kishte konkurruar dhe padrejtesisht, ajo është gjendur përpara situatës së shkurtimit të këtij pozicioni, në një kohë, që po të ishte në pozicionin e saj, mund të mos ndodhej në një situatë të tillë.

Së treti, nëse njësia e burimeve njerëzore do të kishte vepruar në përputhje me ligjin dhe rrethanat e rregullta të zbatimit të tij, edhe në kushtet e shkurtimit të vendit të punës, ishin të gjitha kushtet për vënien e kësaj nëpunëseje në një pozicion më të përshtatshëm. Kështu, nëse do të veprohej drejt në momentin e suprimimit të pozicionit të punës, qoftë edhe në kushtet e qenies

nëpunëse civile në periudhë prove, ajo do të kalonte në listë pritje, e cila do të ishte efektive për dy vjet e, me krijimin e një pozicioni të lirë, ajo mund të emërohej direkt nga lista e pritjes, pa qënë nevoja për të marrë pjesë në konkurrim dhe të kryejë përsëri periudhën e provës.

Konkluzion: Në këto kushte, nisur nga gjithë sa analizuar më sipër, Komisioneri vlerëson se jemi në kushtet e zbatimit të gabuar të ligjit, të kryer e të lejuar nga njësia e burimeve njerëzore. Nisur nga fakti që kjo punonjëse, padrejtësisht nuk është konfirmuar në fund të periudhës së provës, çfarë më pas ka sjellë pasojën që, në rastin e shkurtimit/ristrukturimit të vendit të punës, në kundërshtim me rrethanat faktike, me kërkesat dhe procedurën e kërkuar nga ligji, atë nuk e kanë kaluar në listë pritje, por e kanë larguar nga shërbimi civil, Komisioneri vlerëson se në bazë të neneve 115, pika “a” dhe 116, pika “c”, të ligjit nr. 8485, dt. 12.5.1999, “Kodi i Procedurave Administrative të RSH”, ndodhemi në kushtet e veprimeve administrative absolutisht të pavlefshme, të cilat në bazë të nenit 117, pika 1, të ligjit në fjalë, nuk mund të prodhojnë pasoja, pavarësisht nëse janë deklaruar apo jo si të tillë.

Për këtë shkak, gjithë veprimet e mëvonshme, bien për të njëjtën arsye, prandaj për rregullimin e situatës, në kushtet kur punonjësja *****, aktualisht është e punësuar në pozicionin “Specialiste e INU, në Drejtorinë e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore”, duhet të ndërpresë periudhën e provës, t’i deklarohet statusi i nëpunësit civil të konfirmuar, e gjithë të drejtat që rrjedhin prej tij në këtë pozicion.

c. Nëpunës, të cilëve nuk u është deklaruar statusi i punësimit.

c/1. Konstatohet se në 4 raste, nëpunësve ekzistues që ushtrojnë funksione në fushën e veprimit të ligjit për shërbimin civil, nuk u është bërë deklarimi i statusit të punësimit nga ana e njësisë përgjegjëse, për shkak të mosplotësimit të kriterëve të posaçme (*kriteri arsimor - arsimi i mesëm*).

Njësia përgjegjëse në nxjerrjen e këtyre akteve administrative i është referuar nenit 19, të ligjit nr.152/2013, “Për nëpunësin civil”, (i ndryshuar) dhe Vendimit nr. 142, datë 12.03.2014 “Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe të pavarura”, të Këshillit të Ministrave; Lidhja nr. 2, “Përshkrimi i përgjithëm i punës për çdo kategori dhe klasë”.

Konkretisht, punonjësit për të cilët është vendosur refuzimi i deklarimit të statusit të punësimit, janë:

1. ***** në pozicionin e punës “Inspektor i Inspektoriatit të Mbrojtjes së Tokës”. Kjo punonjëse nuk ka patur arsimin përkatës për këtë pozicion pune dhe për këtë arsye, me aktin nr.130/1 prot., datë 02.04.2014, “Transferim punonjësi”, të Kryetarit të Këshillit të Qarkut Fier, është transferuar me detyrë në N.R.M.Ruga Rurale në Sektorin e Lushnjes, si punëtoare mirëmbajtje;
2. ***** në pozicionin e punës “Specialist në Drejtorinë e Përkujdesjes Sociale”, është larguar nga detyra me Vendimin nr.11, datë 24.02.2014, “Për largimin nga shërbimi civil”, të Kryetarit të Këshillit të Qarkut Fier, pasi nuk kishte arsimin e duhur për pozicionin e punës ku ajo ishte emëruar. Marrëdhëniet financiare të kësaj punonjëseje janë ndërprerë në datë 28.02.2014.

3. *****, në pozicionin e punës “Përgjegjëse e Protokoll Arkivës në Drejtorinë e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore”, është larguar nga detyra me aktin nr.93/26 prot., datë 02.02.2015, të Kryetarit të Këshillit të Qarkut Fier, pasi nuk kishte arsimin e duhur për pozicionin e punës ku ajo ishte emëruar. Marrëdhëniet financiare janë ndërprerë në 02.03.2015.
4. *****, emëruar me Vendimin nr. 510/2, datë 01.07.2012, të Kryetarit të Këshillit të Qarkut Fier (pa konkurrim) në pozicionin “Specialist në Drejtorinë e Përkujdesjes Sociale”. Në periudhën Mars 2013 – Mars 2014 ka qenë me ”Kontratë për leje lindje”. Me Vendimin nr. 220, datë 03.03.2014, “Për lirim nga shërbimi civil”, të Kryetarit të Këshillit të Qarkut Fier, është vendosur lirim nga shërbimi civil, pasi nuk kishte arsimin e duhur për pozicionin e punës ku ajo ishte emëruar.

Konkluzion: Komisioneri vlerëson se Drejtoria e Burimeve Njerëzore, si njësi përgjegjëse, e ngarkuar nga ligji për të formalizuar aktin e deklaramit të statusit, ka vepruar drejt sipas përcaktimeve të nenit 66, gërma ”ë”, të ligjit nr.152/2013, “Për nëpunësin civil”(i ndryshuar); Vendimit 142, datë 12.03.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe të pavarura”; Lidhja nr. 2, “Përshkrimi i përgjithshëm i punës për çdo kategori dhe klasë”, dhe Kreu III pika 6/2 e VKM nr. 116 dt. 5.3.2014, “Për statusin e nëpunësve dhe punonjësve aktualë që përfitojnë statusin e nëpunësit civil sipas ligjit 152/2013 “Për nëpunësin civil” (i ndryshuar), kur ka nxjerrë aktin për lirim nga shërbimi civil për shkak të mosdeklarimit të statusit të punësimit për këto raste. Punonjësit e sipërcituar nuk plotësojnë kërkesën e posaçme për formimin arsimor, çka bie ndesh me kërkesat e ligjit në fuqi.

c/2. Konstatohet se në **5** raste, nuk është bërë deklarimi i statusit të punësimit nga ana e njësisë përgjegjëse për nëpunësit ekzistues që ushtrojnë funksione në fushën e veprimit të ligjit për shërbimin civil, për shkak se në kohën e kryerjes së procesit të deklaramit, ishin larguar nga detyra, me dëshirën e tyre, me dorëheqje. Konkretisht, janë punonjësit e mëposhtëm:

1. *****, emëruar me Vendimin nr. 88, datë 01.02.2013, të Kryetarit të Këshillit të Qarkut në pozicionin “Inspektor i Inspektoriatit të Mbrojtjes së Tokës”, pas procedurës së konkurrimit. Në bazë të kërkesës për dorëheqje, me vendimin nr. 206, datë 28.02.2014, të Kryetarit të Këshillit të Qarkut Fier, është vendosur largimi i këtij nëpunësi nga shërbimi civil.
2. *****, emëruar me vendimin nr. 843/3, datë 15.11.2013 “Për lëvizje paralele”, në pozicionin “Inspektor i Inspektoriatit të Mbrojtjes së Tokës”. Në bazë të kërkesës së këtij punonjësi “Për largim nga detyra me dhënien e dorëheqjes”, është vendosur ndërprerja e marrëdhënieve të tij me institucionin me vendimin nr.242, datë 06.03.2014, “Për lirim nga shërbimi civil”, të Kryetarit të Këshillit të Qarkut.
3. *****, emëruar me vendimin nr. 16, datë 08.07.2011 në pozicionin “Specialist i Zyrës Fier, në Drejtorinë e Administrimit dhe Mbrojtjes së Tokës”. Në bazë të kërkesës së këtij punonjësi më datë 01.04.2014, “Për largim nga detyra me dorëheqje”, është vendosur largimi nga shërbimi civil me vendimin nr. 21, datë 01.04.2014, të Kryetarit të Këshillit të Qarkut Fier.

4. *****, ka filluar marrëdhënien e punës me institucionin me ”Urdhër komandimi” nr.141, datë 13.02.2014, të Kryetarit të Këshillit të Qarkut. Lirohet nga shërbimi civil pas kërkesës për dorëheqje, me Vendimin nr.25, datë 18.07.2014, ”Për lirim nga Shërbimi Civil”, të Kryetarit të Këshillit të Qarkut.
5. *****, me aktin nr. 480/1/41, datë 08.05.2014 ka fituar statusin e nëpunësit civil, në nivelin e mesëm drejtues, në pozicionin Dejtor Drejtorie.
Ka filluar marrëdhënien e punës me institucionin me Vendimin nr.664/2, datë 06.08.20012, të Kryetarit të Këshillit të Qarkut. Lirohet nga shërbimi civil pas kërkesës për dorëheqje, me Vendimin nr.21, datë 18.05.2015, ”Për largim nga shërbimi civil për shkak të dorëheqjes”, të Kryetarit të Këshillit të Qarkut Fier.

Konkluzion: Komisioneri në këtë rast vlerëson se Drejtoria e Burimeve Njerëzore, si njësi përgjegjëse, ka vepruar drejt në nxjerrjen e akteve për lirim nga shërbimi civil për punonjësit e mësipërm, kjo në referencë të nenit 64 dhe 66, pika “dh”, të ligjit nr.152/2013, “Për nëpunësin civil”, (i ndryshuar), i cili parashikon si një nga mënyrat e lirit nga shërbimi civil, nëpërmjet dorëheqjes.

d. Pozicione pune pjesë e shërbimit civil, të plotësuara me akte të përkohshme emërimi, pas hyrjes në fuqi të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar.

Nga analiza e materialeve të verifikuara, rezulton se 3 pozicione pune, pjesë e shërbimit civil në këtë institucion janë plotësuar me akte emërimi të përkohshëm, duke mos respektuar procedurat e parashikuara në nenin 22, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, (i ndryshuar) dhe Vendimin nr.243, datë 12.03.2014, të Këshillit të Ministrave ”Për procedurat e rekrutimit, të përzgjedhjes, të periudhës së provës, të lëvizjes paralele e të ngritjes në detyrë për nëpunësit civilë të kategorisë ekzekutive, të ulët dhe të mesme drejtuese”.

Konkretisht, pozicionet e punës të plotësuara me akte emërimi të përkohshëm, pa konkurrim, janë:

1. *****, emëruar “Specialist në Drejtorinë e Shërbimeve”, me Urdhër nr.41/1, datë 17.03.2014, të Kryetarit të Këshillit të Qarkut Fier. Pas ristrukturimit të institucionit ka kaluar në pozicionin “Përgjegjës për Shërbimet dhe Transportin”, në Drejtorinë Ekonomike dhe Shërbimeve.
2. *****, emëruar “Drejtor në Drejtorinë e Përkujdesjes Sociale”, me Urdhër nr.69, datë 21.07.2014, të Kryetarit të Këshillit të Qarkut Fier. Me vendimin nr.37, datë 19.03.2015, për shkak të ristrukturimit transferohet në pozicionin “Specialist në Drejtorinë e Programim Zhvillimit, Urbanistikës dhe Planifikimit të Territorit”.
3. *****, emëruar në pozicionin “Specialist në Drejtorinë e Përkujdesjes Sociale”, me Urdhër Komandimi nr. 34, datë 17.03.2014, dhe me Urdhrin nr. 51/2, datë 24.04.2014, të Kryetarit të Këshillit të Qarkut Fier, kalon në pozicionin “Specialiste në Drejtorinë e Mjedisit”. Pas ristrukturimit të institucionit, me vendimin nr. 34, datë 19.03.2015 transferohet në pozicionin “Specialiste Mjedisi në Drejtorinë Ekonomike dhe të Shërbimeve”.

Konkluzion: Komisioneri vlerëson se, njësia e burimeve njerëzore ka vepruar në kundërshtim me nenin 22, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar dhe Vendimin nr.143, datë 12.03.2014, të Këshillit të Ministrave, ”Për procedurat e rekrutimit, të përzgjedhjes, të periudhës së provës, të lëvizjes paralele e të ngritjes në detyrë për nëpunësit civilë të kategorisë ekzekutive, të ulët dhe të mesme drejtuese”, kur ka lejuar plotësimin e pozicioneve të mësipërme me “akte emërimi”, ndërkohë që ligji e ndalon këtë gjë dhe kërkon zhvillimin e procedurave të konkurrimit (Për këtë rast do të flitet edhe më poshtë, më hollësisht).

Për rrjedhojë, në bazë të nenit 23, pika 4, të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil” (i ndryshuar) dhe neneve 115/a dhe 116/c, të ligjit nr.8485, datë 12.05.1999, “Kodi i Procedurave Administrative”, aktet e mësipërme të emërimit duhet të deklarohen absolutisht të pavlefshme.

Pavlefshmëria absolute e akteve të emërimit sjell dhe pavlefshmëri absolute të akteve të tjera, me anën e të cilave është bërë lëvizja e tyre në pozicione të ndryshme, pjesë e shërbimit civil, apo transferimi i tyre në pozicionet e strukturës aktuale të Këshillit të Qarkut Fier. Për këtë arsye, pozicionet e mësipërme duhet të shpallen të lira nga njësia përgjegjëse, sipas këtyre hapave:

- të bëjë revokimin e akteve të emërimit të këtyre punonjësve në pozicionet si nëpunës civil, si akte të cilat janë nxjerrë në kundërshtim me ligjin.
- të bëjë revokimin e akteve të transferimit të tyre, të nxjerra në bazë të Vendimit nr. 2, datë 15.01.2015, të Këshillit të Qarkut Fier, “Mbi miratimin e strukturës organizative të administratës së Këshillit të Qarkut Fier për vitin 2015” .
- Pozicionet e mësipërme, sipas strukturës aktuale, “Specialist i INU”, “Specialist në Drejtorinë e Programim Zhvillimit, Urbanistikës dhe Planifikimit të Territorit”, “Përgjegjës për Shërbimet dhe Transportin”, në Drejtorinë Ekonomike dhe Shërbimeve” dhe “Specialist Mjedisi në Drejtorinë Ekonomike dhe të Shërbimeve” duhet të shpallen pozicione të lira dhe të plotësohen sipas procedurave përkatëse të parashikuara në nenet 22 e vijues të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, (i ndryshuar) (ky rast do të trajtohet më hollësisht në pjesët vijuese të materialit).

Ndërkohë, do të veçojmë në këtë rast, konstatimin në projekt raport, në lidhje me marrëdhënien e punës, për punonjësin *****; pasi në momentin e hartimit të raportit të inspektimit konstatohen rrethana të reja, të cilat do t'i parashtrijmë më poshtë:

Punonjësi *****; është emëruar në pozicionin “Kryeinspektor i INU”, me Urdhrin nr.276, datë 18.03.2014, të Kryetarit të Këshillit të Qarkut Fier. Më pas, me Urdhrin nr.863, datë 12.09.2014 “Për ngritje në detyrë” është emëruar në pozicionin “Drejtor i INU”. Si pasojë e ristrukturimit të institucionit në Janar të 2015, me Vendimin nr. 333/9, datë 19.03.2015, të Kryetarit të Këshillit të Qarkut Fier, është vendosur transferimi i tij në pozicionin “Specialist i INU”.

Ndërkohë, janë krijuar rrethana të reja në institucion: pas largimit nga detyra të Drejtorit të Menaxhimit të Burimeve Njerëzore, *****; në një detyrë tjetër, ky pozicion ka qenë i lirë dhe për plotësimin e tij është zhvilluar procedura e konkurrimit sipas kërkesave të ligjit nr.152/2014, ”Për nëpunësin civil” (i ndryshuar). Pasi jemi vënë në dijeni të faktit, në kushtet kur ky punonjës ka nënshkruar projekt raportin si drejtues i njësisë përgjegjëse për administrimin e burimeve njerëzore, nga ana e grupit të punës është kërkuar informacion në lidhje me këtë rast.

Pas kësaj, nga ana e institucionit është paraqitur dokumentacioni që provon se ky punonjës është emëruar në këtë detyrë, me Vendimin nr.65, datë 01.10.2015, të Kryetarit të Këshillit të Qarkut, pasi është shpallur fitues në një procedurë të rregullt rekrutimi.

Pra në këtë rast, konstatohet se është ndërprerë gjendja e paligjshmërisë, e konstatuar në projekt raport, në lidhje me punonjësën *****.

II. Transferimet në shërbimin civil, si pasojë e ristrukturimit të institucionit.

Procesi i ristrukturimit dhe riorganizimit të pozicioneve të punës në një institucion, kalon në disa faza të detyrueshme, të cilat kanë një rradhë të caktuar që burojnë nga ligji, apo rrjedha llogjike e tij dhe duhet treguar shumë kujdes që të mos përfundojë në një lëvizje të thjeshtë njerëzish e pozicionesh. Konkretisht, në kushtet e lindjes së nevojës për ristrukturimin e institucionit, njësitë e burimeve njerëzore, që është mekanizmi i ngarkuar me përgatitjen e kushteve për mbarëvajtjen e procesit, duhet të mbajë parasysh rradhën e punës dhe procedurën e caktuar, e cila fillon me (a) një studim të veçantë, që përlligj nevojën e institucionit për t'u përfshirë në ristrukturim, duhet të vazhdojë me (b) hartimin e përshkrimit të pozicioneve të punës e përcaktimin e kërkesave të përgjithshme e të veçanta për vendet e reja të punës që do të krijohen rishtas, apo ato që do të ristrukturohen, me qëllim që të bëhet sa më shumë të jetë e mundur sistemimi i punonjësve ekzistues, si dhe (c) me parashikimin e pasojave financiare që sjell ky proces.

Po kështu, në këtë rast duhet të mbahet parasysh edhe detyrimi ligjor që nuk e lejon përfundimin e marrëdhënieve në shërbimin civil për shkak të ristrukturimit apo mbylljes së institucionit, çka do të thotë se institucioni duhet të sistemojë nëpunësit ekzistues brenda numrit të përgjithshëm të nëpunësve civilë, apo në ndonjë nga mënyrat e parashikuara në pikën 2, të nenit 50, të ligjit nr.152/2013, "Për nëpunësin civil"(i ndryshuar). Ligji parashikon si rast përjashtimor, përfundimin e marrëdhënieve me shërbimin civil, vetëm nëse nëse ka shkurtime të numrit të përgjithshëm të nëpunësve civilë dhe transferimi i nëpunësve sipas kushteve të dispozitës të përmendur më sipër, është i pamundur dhe në këtë rast, lirimi duhet të shoqërohet me të drejtën për dëmshpërblim, si dhe të drejtën për të konkurruar si nëpunës civil nëpërmjet lëvizjes paralele apo ngritjes në detyrë, për një periudhë 2 vjeçare. Zbatimi i kërkesave ligjore në këtë rast, shërben si garanci që procesi i ristrukturimit të mos përdoret si mjet për largimin e nëpunësve nga shërbimi civil.

Më poshtë po analizojmë strukturat me të cilat ka funksionuar institucioni për periudhën 2014-2015, të cilat janë edhe aktet që materializojnë procesin e ristrukturimit. Nëpërmjet krahasimit të tyre, do të nxjerrim ndryshimet që kanë ndodhur, si dhe problematikat e hasura në këtë rast.

- Struktura e miratuar me Vendimin nr. 4, datë 07.02.2014 "Për miratimin e strukturës organizative të Administratës së Këshillit të Qarkut Fier".

Në këtë rast, në përbërje të administratës së Këshillit të Qarkut, kanë qenë gjithsej **59** pozicione pune, nga të cilët: **48** pozicione pjesë e shërbimit civil dhe **11** pozicione në funksione mbështetëse, në mënyrë të detajuar si më poshtë:

- Kryetar i Këshillit të Qarkut	1
- Sekretar i kryetarit	1

- Nënkryetar	2
- Sekretar i Këshillit të Qarkut	1
- Shef kabineti	1
1. Drejtoria e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore	8
Drejtor	1
Specialist	2
Përgjegjës protokoll-arshivës	1
Shofer	2
Pastruese	1
Zëdhënës shtypi	1
2. Drejtoria e Program Zhvillimit Rajonal	5
Drejtor	1
Specialist	4
3. Drejtoria e Mjedisit	4
Drejtor	1
Specialist i nivelit të lartë	3
4. Drejtoria e Turizmit dhe Kulturës	4
Drejtor	1
Specialist	2
Specialist informacioni	1
5. Drejtoria e Shërbimeve Rajonale	5
Drejtor	1
Specialist i nivelit të lartë	4 (2 pozicione të lira)
6. Drejtoria e Planifikimit dhe Kontrollit Urban	9
Drejtor	1
Specialist i nivelit të lartë	5
6.1 Inspektoriati Ndërtimor Urbanistik	3
Kryeinspektori INU	1 (pozicion i lirë)
Specialist i nivelit të lartë	1
Jurist	1
7. Drejtoria e Financës	5
Drejtor	1
Specialist i nivelit të lartë	2
Specialist IT	1
Magaziniere	1 (jo n/punes civil)
8. Drejtoria e Juridike	5
Drejtor	1
Specialist i nivelit të lartë	2
Koordinator	2

9. Drejtoria e përkujdesjes sociale	5
<i>Drejtor</i>	<i>1</i>
<i>Specialist</i>	<i>4</i>
10. Inspektoriati i Mbrojtjes së Tokës	3
<i>Kryeinspektor</i>	<i>1</i>
<i>Specialist i nivelit të lartë</i>	<i>2</i>

Me Vendimin nr.8, datë 07.02.2014, është vendosur numri i punonjësve të "Seksionit të Administrimit dhe Mbrojtjes së Tokës":

1. Përgjegjës seksioni	1
2. Përgjegjës zyre	3 (1 pozicion i lirë)
3. Specialist	4

Nga inspektimi është konstatuar se, sipas kësaj strukture, institucioni ka pasur **3** pozicione të lira pjesë e shërbimit civil, që i përkasin: **2** (dy) pozicione "Specialist në Drejtorinë e Shërbimeve Rajonale" dhe **1** (një) pozicion "Kryeinspektor në Inspektoriatin e Ndërtimit dhe Urbanistikës", si dhe **1** (një) pozicion të lirë "Përgjegjës zyre" në "Seksionin e Administrimit dhe Mbrojtjes së Tokës" (DAMT).

- Struktura e miratuar me Vendimin nr.2, datë 15.01.2015, të Këshillit të Qarkut Fier, "Mbi miratimin e strukturës organizative të administratës së Këshillit të Qarkut Fier për vitin 2015".

Sipas kësaj strukture, numri i përgjithshëm i pozicioneve të punës ka qenë **25**, nga të cilët **16** pozicione pune, janë pjesë e shërbimit civil dhe **9** pozicione pune janë funksione mbështetëse.

Struktura e aparatit të institucionit aktualisht është e organizuar në këtë mënyrë:

- Kryetar i Këshillit të Qarkut	1
- Sekretar i kryetarit	1
- Nënkyetar	2
- Sekretar i Këshillit të Qarkut	1
1. Drejtoria e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore	6
<i>Drejtor</i>	<i>1</i>
<i>Specialist i Burimeve Njerëzore dhe Protokoll Arshivës</i>	<i>1</i>
<i>Specialist për Marrëdhëniet me Jashtë</i>	<i>1</i>
<i>Jurist</i>	<i>1</i>
<i>Specialist i INU</i>	<i>2</i>
2. Drejtoria e Program Zhvillimit dhe Planifikimit Territorit	5
<i>Drejtor</i>	<i>1</i>
<i>Specialist</i>	<i>4</i>

3. Drejtoria Ekonomike dhe e Shërbimeve	5
<i>Drejtor</i>	<i>1</i>
<i>Përgjegjës Specialist për Shërbimet dhe Transportin</i>	<i>1</i>
<i>Specialist finance</i>	<i>1</i>
<i>Specialist mjedisi</i>	<i>1</i>
<i>Specialist turizmi</i>	<i>1</i>
4. Me kontratë shërbimi	4
<i>Shofer</i>	<i>1</i>
<i>Sanitare</i>	<i>1</i>
<i>Roje</i>	<i>2</i>

Gjithsej 25 pozicione pune

Duke krahasuar këto dy struktura, konstatohet se në strukturën e miratuar në Janar 2015, kemi një pakësim të ndjeshëm të pozicioneve të punës. Këshilli i Qarkut Fier ka kaluar një proces ristrukturimi, ku konstatohet plotësimi i të dy kërkesave ligjore për të pasur një proces ristrukturimi: së pari shkurtimi i numrit të përgjithshëm të nëpunësve civilë dhe së dyti, ndryshimi i strukturës organizative. Në strukturën e mësipërme funksionet e Këshillit të Qarkut Fier, tashmë, kryhen vetëm nga **3** Drejtori, për rrjedhojë është shkurtuar numri i përgjithshëm i nëpunësve civilë: nga **48**, në **16** nëpunës civilë, që janë pozicionet e cituar më lart.

Në strukturën e institucionit të Këshillit të Qarkut Fier, përfshihet edhe Drejtoria e Administrimit dhe Mbrojtjes së Tokës, e cila funksionon mbi bazën e ligjit nr. 8752, datë 26.03.2001 “Për krijimin dhe funksionimin e strukturave për administrimin dhe mbrojtjen e tokës”, ndryshuar me ligjin nr. 10257, datë 25.03.2010 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 8752, datë 26.03.2001 “Për krijimin dhe funksionimin e strukturave për administrimin dhe mbrojtjen e tokës”.

Mënyra e organizimit dhe funksionimit të kësaj strukture, parashikohet në nenin 5 dhe 6 të ligjit të sipërcituar ku përcaktohet se, “drejtori dhe specialistët e DAMT-së emërohen dhe shkarkohen në përputhje me ligjin nr. 8549, datë 11.11.1999 “Statusi i nëpunësit civil”.

Kjo drejtori ka gjithsej **8** pozicione pune pjesë e shërbimit civil, ndarë në këto kategori:

- Nëpunës civilë të nivelit të mesëm drejtues, rezulton të jetë **1** pozicion pune, që i përket nivelit “*Drejtor Drejtorie*”;
- Nëpunës civilë të nivelit të ulët drejtues janë **3** pozicione pune, të cilat i përkasin nivelit “*Përgjegjës Sektori*”;
- Nëpunës civilë të nivelit ekzekutiv janë **4** pozicione pune, të cilat i përkasin nivelit “*specialist*”.

Struktura me të cilën funksionon Drejtoria e Administrimit dhe Mbrojtjes së Tokës, është e organizuar në këtë mënyrë:

1. ******, në pozicionin “*Drejtor*”, në Drejtorinë e Administrimit dhe Mbrojtjes së Tokës.
Kjo punonjëse ka filluar marrëdhënien e punë me institucionin me Vendim nr.33, datë 20.11.2013, “Për emërim në detyrë”, të Kryetarit të Këshillit të Qarkut. Pas konkurrimit,

me Vendimin nr.33/1, datë 14.01.2014, të Kryetarit të Këshillit të Qarkut është emëruar në pozicionin aktual.

2. *****, në pozicionin “*Specialist*”, në Drejtorinë e Administrimit dhe Mbrojtjes së Tokës.
Pas procedurës së konkurrimit, është emëruar në detyrë me Vendimin nr. 46, datë 01.03.2005, të Kryetarit të Këshillit të Qarkut. Me njoftimin nr. 56 dt. 21.01.2013, është larguar nga shërbimi civil dhe është rikthyer në këtë pozicion në zbatim të Vendimit nr. 3057, datë 10.06.2014 të Gjykatës Administrative. Ndërkohë që vendimi i gjykatës ende nuk kishte marrë formë të prerë, me Urdhër nr. 22/1, datë 21.02.2014, të Kryetarit të Këshillit të Qarkut, është transferuar në detyrën “*Specialist në DAMT Fier*”.
3. *****, në pozicionin “*Specialist*”, në Drejtorinë e Administrimit dhe Mbrojtjes së Tokës.
Pas procedurës së konkurrimit, është emëruar në detyrë me Vendimin nr 13, datë 23.07.2007, të Kryetarit të Këshillit të Qarkut.
4. *****, në pozicionin “*Përgjegjës i Zyrës në Lushnje*”, në Drejtorinë e Administrimit dhe Mbrojtjes së Tokës.
Punonjësi ka filluar marrëdhënien e punës me institucionin në pozicionin “*Drejtor i Përkujdesjes Sociale*”, në datë 06.01.2014, me Urdhër të Kryetarit të Këshillit të Qarkut. Pas procedurës së konkurrimit, është emëruar në detyrë me Vendimin nr.1/2, datë 10.02.2014, të Kryetarit të Këshillit të Qarkut. Pas ristrukturimit, me Vendimin nr. 42, datë 02.05.2015, të Kryetarit të Këshillit të Qarkut, emërohet në pozicionin “*Përgjegjës i Zyrës në Lushnje*”, në Drejtorinë e Administrimit dhe Mbrojtjes së Tokës”.
5. *****, në pozicionin “*Specialist në Zyrën e Fierit*”, në Drejtorinë e Administrimit dhe Mbrojtjes së Tokës.
Ky punonjës ka filluar detyrën pas procedurës së konkurrimit, me Vendimin nr. 1422/6, datë 01.12.2007, të Kryetarit të Këshillit të Qarkut, si “*Specialist ne Drejtorinë e Program Zhvillimit*”. Pas ristrukturimit, transferohet në detyrën aktuale me Vendimin nr.5/1, datë 27.02.2015 “*Për transferim në Drejtorinë e AMT, Zyra Fier*”.
Me anë të aktit administrativ “*Njoftim*” nr. 826 prot., datë 29.07.2015, të Drejtorisë së Menaxhimit të Burimeve Njerëzore të Këshillit të Qarkut Fier, në mbështetje të ligjit nr.152/2013 “*Për Nëpunësin Civil*” (i ndryshuar), neni 37 “*Të drejtat politike*” pika 3, neni 54, “*Pezullimi për shkak të ligjit*”, neni 55, “*Pezullimi me kërkesë të nëpunësit*” dhe neni 56, “*Efektet e pezullimit*”, është bërë pezullimi nga detyra i nëpunësit, për shkak të kandidimit në organet e zgjedhura vendore.

Pas shpërndarjes së mandateve për Këshillat Bashkiake, punonjësi *****, rezultoi fitues dhe me aktin nr. 913/1, dt. 02.10.2015, për shkak të ligjit, është pezulluar nga detyra pranë Këshillit të Qarkut Fier, për kohën që ushtron këtë mandat. Me përfundimin e mandatit, në bazë të nenit 56, pika 1, të ligjit nr. 152/2013 “*Për nëpunësin civil*” (i ndryshuara), ky punonjës duhet të kthehet në pozicionin e mëparshëm të punës, ose, në rast se pozicioni i punës është i plotësuar përfundimisht, ai transferohet në një vend tjetër të së njëjtës kategori, ose në pamundësi do të rregjistrohet në një listë, e cila

administrohet nga njësia përgjegjëse, deri në sistemimin e tij në një pozicion të rregullt të shërbimit civil.

6. *****, në pozicionin “*Specialist i Zyrës Lushnjë*”, në Drejtorinë e Administrimit dhe Mbrojtjes së Tokës.
Punonjësi ka filluar detyrën pas procedurës së konkurrimit, me Vendimin nr 59, datë 05.07.2006, të Kryetarit të Këshillit të Qarkut. Me fillimin e efekteve të ligjit nr.152/2013, “*Për nëpunësin civil*” (i ndryshuar), njësia e personelit me të drejtë ka bërë deklarinimin e statusit të punësimit me aktin nr 480/1/35, datë 08.05.2015, nëpunës civil i nivelit ekzekutiv. Pas ristrukturimit, me Vendimin nr. 17, datë 01.07.2015, “*Për transferim në Drejtorinë e AMT, Zyra Fier*”, ka kaluar në detyrën që mban aktualisht “*Specialist i Zyrës Lushnjë*”, në Drejtorinë e Administrimit dhe Mbrojtjes së Tokës.
7. *****, në pozicionin “*Përgjegjës i Zyrës së Mallakastrës*”, në Drejtorinë e Administrimit dhe Mbrojtjes së Tokës.
Konstatohet se pasi ka kryer procedurën e konkurrimit, është emëruar në detyrë me Vendimin nr 42, datë 16.02.2003, në pozicionin “*Specialist i Zyrës Mallakastër në DAMT*”. Pas ristrukturimit, me Urdhërin nr. 550, datë 12.05.2015 “*Urdhër komandimi*”, transferohet në detyrën “*Përgjegjës i Zyrës Mallakastër në DAMT*”. Nga materialet e administruara, rezulton se mënyra si është trajtuar ky rast, vjen në kundërshtim me rregullimin që i bën institutit të transferimit të përkohshëm, neni 48 i ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”(i ndryshuar). Sipas kësaj dispozite, lejohet transferimi i përkohshëm (*ose siç thuhet: komandimi*), por ndërkohë institucioni ka për detyrë që të ruajë të njëjtën kategori, ndërsa në rastin konkret, kjo kërkesë ligjore nuk është respektuar. Kalimi nga niveli i specialistit, në nivelin e përgjegjësit të zyrës, duhet të realizohet nëpërmjet procedurës së ngritjes në detyrë. Në këto rrethana, për rregullimin e situatës, ky “*komandim*” duhet të ndërpritet, akti duhet të revokohet dhe nga ana e njësies së burimeve njerëzore, duhet të fillojnë procedurat ligjore për plotësimin e pozicionit të punës përgjegjës i zyrës në DAMT, sipas kërkesave të neneve 22 e vijues, të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*” (i ndryshuar) dhe akteve nënligjore përkatëse.
- *Struktura aktuale, me të cilën ende funksionon edhe në momentin e inspektimit, miratuar me Vendimin nr. 37, datë 01.06.2015, “Për miratimin e ndryshimit të strukturës organizative të Administratës së Këshillit të Qarkut Fier të vitit 2015”(të miratuar me vendimin nr. 2 dt. 15.01.2015).*

Konstatohet se struktura e miratuar me vendimin nr. 37, dt. 01.06.2015, të Këshillit të Qarkut Fier, nuk ka sjellë si pasojë shtimin apo pakësimin e numrit të përgjithshëm të nëpunësve civilë, por ka ndryshuar emërtimin e Drejtorisë së Programim Zhvillimit dhe Planifikimit të Territorit duke e emërtuar “*Drejtoria e Program Zhvillimit, Urbanistikës dhe Planifikimit të Territorit*”. Kjo drejtori, aktualisht ka këtë përbërje:

- Drejtor	1
- Specialist	2
- Përgjegjës i Zyrës së Urbanistikës dhe Planifikimit të Territorit	1
- Specialist i Zyrës së Urbanistikës dhe Planifikimit të Territorit	1

Pas verifikimit të dokumentacionit përkatës, u konkludua se emërimet në këtë drejtori janë bërë në përputhje me kërkesat e nenit 50, të ligjit nr 152/2013, “Për nëpunësin civil” (i ndryshuar), Vendimit nr.171, dt.26.03.2014 të Këshillit të Ministrave “Për transferimin e Përhershëm dhe të Përkohshëm të Nëpunësve Civilë, Pezullimin dhe Lirimin nga Shërbimi Civil”, Kreu III i tij, si dhe Vendimit 142, datë 12.03.2014 të Këshillit të Ministrave “Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe të pavarura”, lidhja 2, “Përshkrimi i përgjithshëm i punës për çdo kategori dhe klasë”.

Ashtu siç konstatohet nga emërtimi, si dhe nga pozicionet në shërbimin civil në këtë drejtori, është mbajtur parasysh edhe specifika e secilit pozicion, e cila ka diktuar dhe arsimin përkatës. Kemi parasysh këtu që, për pozicionet “Përgjegjës” dhe “Specialist” i Zyrës së Urbanistikës dhe Planifikimit të Territorit, është respektuar kriteri arsimor, duke punësuar punonjës me diplomë në “Inxhinieri Ndërtimi” dhe “Inxhinieri Agrare”, sipas përshkrimit të punës për secilin pozicion.

II/1. Rregullimi ligjor i procesit të ristrukturimit dhe si ka vepruar institucioni për zbatimin e procedurës që duhet të ndiqet në këtë rast.

Procesi i ristrukturimit fillon të materializohet me miratimin e strukturës së re të institucionit dhe në përmbajtje përbëhet nga të gjitha aktet administrative që realizon njësi përgjegjëse gjatë implementimit të tij, ndër të cilat përmendim aktet e krijimit dhe të funksionimit të Komisionit të Ristrukturimit; aktet e lirimit të nëpunësve që u është deklaruar i tepërt pozicioni i punës; aktet e riemërimit të nëpunësve të mbetur pas ristrukturimit, etj.

Ky proces realizohet nga njësi përgjegjëse, mbështetur tek rregullat e përcaktuara në nenin 50, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, (i ndryshuar); në Vendimin nr.142, datë 12.03.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura”, si dhe në Vendimin nr.171, datë 26.03.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për transferimin e përhershëm dhe të përkohshëm të nëpunësve civilë, pezullimin dhe lirimin nga shërbimi civil”, të cilat e kanë vendosur këtë hallkë, në krye të procesit të ristrukturimit, për t’u kujdesur edhe në drejtim të anës procedurale ligjore.

Sipas këtyre dispozitave, njësi përgjegjëse ngre Komisionin e Ristrukturimit për menaxhimin dhe implementimin e procesit të ristrukturimit dhe pas propozimit të bërë prej tij, ka detyrimin ligjor për marrjen e vendimit përfundimtar për lirimin nga shërbimi civil, të nëpunësve të cilëve u është shpallur i tepërt pozicioni i punës, ose i ka ndryshuar përshkrimi i punës.

Nga analiza që iu bë procesit të ristrukturimit dhe akteve që e kanë materializuar atë, rezulton se shkak që ka diktuar këtë proces, ka qenë pakësimi i fondit në buxhetin e institucionit, në zbatim të nenit 15, të Ligjit 160/2014, “Për buxhetin e vitit 2015”.

Ky kufizim solli si pasojë edhe ndryshimet në strukturën e institucionit, që u materializuan në Vendimin nr.2, datë 15.01.2015, të Këshillit të Qarkut Fier, “Mbi miratimin e strukturës organizative të administratës së Këshillit të Qarkut Fier për vitin 2015”.

Në këto kushte, në zbatim të pikës 3, të nenit 50, të ligjit nr. 152/2013, *“Për nëpunësin civil”* (i ndryshuar) dhe pikës 17, të Vendimit nr.171, datë 26.03.2014, të Këshillit të Ministrave, *“Për transferimin e përhershëm dhe të përkohshëm të nëpunësve civilë, pezullimin dhe lirin nga shërbimi civil”*, njësia përgjegjëse kishte detyrimin të krijonte Komisionin e Ristrukturimit, i cili do të vlerësonte mundësinë e sistemimit të çdo nëpunësi civil në vendet e mbetura, apo transferimin e tyre në pozicionet e krijuara rishtas apo ristrukturuar, të së njëjtës kategori.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit përkatës, vërehet se, nga ana e institucionit janë mbajtur parasysh kërkesat e ligjit për realizimin e këtij procesi. Më poshtë po rendisim dhe analizojmë me radhë, arsyet që argumentojnë këtë përfundim.

Kështu, konstatohet se, pas miratimit të strukturës me Vendimin nr.2, datë 15.01.2015, të Këshillit të Qarkut Fier, ka dalë akti administrativ që urdhëron ngritjen e Komisionit të Ristrukturimit: Urdhër nr.4/2 datë 02.02.2015, i Kryetarit të Këshillit të Qarkut Fier, *“Ngritje e Komisionit të Ristrukturimit”*, nga përmbajtja e të cilit, rezulton se Komisioni i Ristrukturimit është i përbërë nga: Zv/Kryetarja e Këshillit të Qarkut, *****, Drejtori i Menaxhimit të Burimeve Njerëzore, ***** dhe *****, Drejtor Finance.

Më tej, sipas Procesverbalit nr. 1, datë 02.02.2015, në përmbushje të detyrimeve ligjore të përcaktuara në pikën 3, të nenit 50, të ligjit nr. 152/2013, *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar, në Vendimin nr.171, dt. 26.03.2014 të Këshillit të Ministrave *“Për transferimin e përhershëm dhe të përkohshëm të nëpunësve civilë, pezullimin dhe lirin nga shërbimi civil”*, ky komision ka marrë në analizë pozicionet e punës të mbetura, apo të ristrukturuara të institucionit dhe në përfundim ka propozuar në mënyrë nominale nëpunësit civilë, që janë vlerësuar si të përshtatshëm për të vazhduar detyrën në shërbimin civil. Në përfundim, komisioni ka kërkuar nga Drejtoria e Burimeve Njerëzore, aprovimin e këtij *“Propozimi”*, sipas të cilit gjithë kompetencat dhe funksionet e Këshillit të Qarkut, do të ushtrohen nga një numër më i vogël punonjësish.

Njësia përgjegjëse, bazuar në pikën 7, të nenit 50, të ligjit nr. 152/2013, *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar, pasi ka marrë propozimin e mësipërm dhe ka shqyrtuar edhe një herë dokumentacionin e nevojshëm ligjor për secilin nëpunës (*dosjen personale*), përshkrimet e punës të pozicioneve të ristrukturuara, kriteret specifike të vendeve të lira të krijuara, vlerësimin vjetor dhe vjetërsinë në punë të secilit nëpunës, ka nxjerrë aktet e riemërimit pas ristrukurimit për ata punonjës që do të mbaheshin në punë dhe aktet e lirit nga detyra të atyre nëpunësve, të cilëve u ishte suprimuar vendi i punës, të cilat janë formalizuar më tej edhe nga drejtuesi i institucionit.

Hartimi i përshkrimeve të punës, për të gjitha pozicionet që janë pjesë e shërbimit civil, është bërë sipas parashikimeve të ligjit nr. 152/2013, *“Për nëpunësin civil”*, (i ndryshuar), që përbën një kusht pa të cilin nuk mund të kryhet risistemimi i punonjësve në të njëjtin pozicion, transferimi apo përfitimet e tjera të punonjësve në rastin e ristrukurimit.

Në rastet e kur procesi është kushtëzuar me ulje në detyrë të punonjësit, rezulton se atij i është marrë mendimi me shkrim, për pranimin ose refuzimin e pozicionit të ofruar, siç përcaktohet në pikën 19 dhe 20, Kreu III *“Transferimi për shkak të mbylljes dhe ristrukurimit të institucionit”*, të Vendimit nr.171, datë 26.03.2014 të Këshillit të Ministrave *“Për transferimin e përhershëm dhe të përkohshëm të nëpunësve civilë, pezullimin dhe lirin nga shërbimi civil”*.

Më poshtë, do të trajtohet në mënyrë analitike gjithë procesi i ristrukturimit, për çdo punonjës që ka qenë në marrëdhënie pune me institucionin, në pozicione pune që janë pjesë e shërbimit civil, dhe që pas implementimit të strukturës së re, janë mbajtur brenda numrit të pozicioneve të mbetura, ose që janë liruar për shkak të shkurtimeve të pozicionit të punës. Në përmbajtjen e çdo rasti, gjenden edhe argumentat që kanë shërbyer për të dalë në konkluzionin përfundimtar.

a. Situata në lidhje me punonjësit që janë sistemuar në këtë institucion, pas ristrukturimit.

Më poshtë po paraqesim në mënyrë të detajuar procesin e ristrukturimit, në lidhje me punonjësit që janë përfshirë në këtë proces dhe ende vijojnë të kryejnë funksionet e tyre në këtë institucion, duke bërë analizën e secilit rast në raport me statusin e punësimit dhe duke nënvizuar për secilin punonjës, ekzistencën ose jo të statusit të nëpunësit civil.

1. *****, fillimisht, është emëruar në pozicionin “Drejtor i Menaxhimit të Burimeve Njerëzore” (nëpunës civil i nivelit të mesëm drejtues), me Vendimin nr. 19, datë 05.11.2013, të Kryetarit të Këshillit të Qarkut “Për emërim në detyrë”. Pas përfundimit të procedurave të konkurrimit, është emëruar në të njëjtin pozicion pune me Vendimin nr.19/1, datë 23.02.2014, të Kryetarit të Këshillit të Qarkut, “Për emërimin Drejtor, në Drejtorinë e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore” dhe me aktin nr. 480/1/1, datë 08.05.2014, është deklaruar “nëpunës civil në periudhë prove”. Pas përfundimit të periudhës së provës, me aktin nr.807/8/1, datë 30.12.2014, është konfirmuar “Nëpunës Civil”.

Në këtë rast, njësia përgjegjëse, me të drejtë ka nxjerrë aktin e deklarimit të statusit të punësimit, nr.480/1/1, datë 08.05.2014, në kategorinë “Nëpunës civil në periudhë prove”, në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil” (i ndryshuar), për këtë punonjës.

Pas ristrukturimit, rezulton se ky nëpunës është riemëruar në të njëjtin pozicion që kishte para ristrukturimit dhe aktualisht gëzon statusin e nëpunësit civil.

2. *****, ka qenë nëpunëse civile në institucionin e Këshillit të Qarkut Fier, duke filluar nga viti 2006. Rezulton se me shkresën nr.510/3 prot., dt.09.07.2012, të Kryetarit të Këshillit të Qarkut, është liruar nga shërbimi civil, ndërkohë që është rikthyer me Vendimin nr.109, datë 18.12.2013, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, me argumentin se pushimi nga puna ishte i padrejtë. Në zbatim të këtij vendimi të formës së prerë, me aktin nr. 12, datë 08.11.2013, të Kryetarit të Këshillit të Qarkut, është riemëruar në detyrë në pozicionin “Specialist në Drejtorinë e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore”.

Njësia përgjegjëse, me të drejtë ka nxjerrë aktin e deklarimit të statusit të punësimit, nr.480/1/15 datë 08.05.2014, në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil” (i ndryshuar) për këtë punonjëse, duke e konfirmuar si nëpunëse civile.

Pas ristrukturimit, kjo nëpunëse është riemëruar në të njëjtin pozicion që kishte para ristrukturimit dhe aktualisht gëzon statusin e nëpunësit civil.

3. *****, është emëruar me Urdhërin nr. 13, datë 08.11.2013 të Kryetarit të Këshillit të Qarkut, “Për emërim në detyrë”, në pozicionin “Specialist në Drejtorinë e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore”.

Rezulton se pas procedurave të konkurrimit, me Vendimin nr.13/2 datë 08.01.2014, të Kryetarit të Këshillit të Qarkut, është emëruar “Specialiste në Drejtorinë e Menaxhimit të

Burimeve Njerëzore". Me aktin nr. 480/1/2, datë 08.05.2014 është deklaruar "*nëpunës civil në periudhë prove*" në pozicionin specialist. Pas përfundimit të periudhës së provës, me aktin nr.841/8/1, datë 30.12.2014, është konfirmuar si "*nëpunës civil*", në të njëjtën detyrë, të cilën e mban edhe pas ristrukturimit.

Kjo nëpunëse aktualisht, krahas detyrës si specialiste në Drejtorinë e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore, është ngarkuar të kryejë edhe detyrën për pozicionin e punës "*Specialist Protokoll - Arkive*", të cilën më parë e kryente punonjësja *****, e cila është larguar nga shërbimi civil me Vendimin nr.23, dt.02.03.2015 "*Për lirim nga Shërbimi Civil*", të Kryetarit të Qarkut Fier, për mungesë të arsimit të lartë.

4. ***** , me Urdhrin nr. 276, dt.18.03.2014, të Kryetarit të Këshillit të Qarkut Fier, është emëruar me detyrën "*Kryeinspektor i INU*". Më pas, me Urdhrin nr.863, dt.12.09.2014, të Kryetarit të Këshillit të Qarkut Fier, është emëruar në detyrë në pozicionin "*Drejtor i INU*". Pas ristrukturimit, është liruar nga detyra e drejtorit dhe me Vendimin nr. 33, dt.19.03.2015, të Kryetarit të Këshillit të Qarkut Fier, është vendosur kalimi i tij në pozicionin "*Specialist i INU*", pranë Drejtorisë së Burimeve Njerëzore. Ashtu si pasqyrohet në dokumentacionin e përshkruar më sipër, marrëdhënia e punës për këtë punonjës është lidhur në kundërshtim me kërkesat e ligjit, pasi në kohën që ka dalë akti i emërimit, kishin filluar efektet e ligjit nr. 152/2013, "*Për nëpunësin civil*" (i ndryshuar) prandaj akti i emërimit të tij, duke mos respektuar procedurën e konkurrimit, parashikuar në nenet 22 e vijues të ligjit në fjalë, në bazë të nenit 23, pika 4, të po këtij ligji, është absolutisht i pavlefshëm.

Ndërkohë, nisur nga kushtet që kemi parashtruar në kapitullin që bën fjalë për emërimet e përkohshme, ku e kemi trajtuar këtë rast, rezulton se kanë ndryshuar rrethanat, e për pasojë është ndërprerë gjendja e paligjshmërisë.

5. ***** , ka filluar marrëdhënien e punës me institucionin me Urdhër nr.25, datë 20.02.2014, të Kryetarit të Këshillit të Qarkut, në pozicionin "*Drejtor i Drejtorisë së Mjedisit*". Konstatohet se megjithëse ky punonjës e ka lidhur marrëdhënien e punës para fillimit të efekteve të ligjit nr. 152/2013, "*Për nëpunësin civil*" (i ndryshuar) dhe mund të përfitonte nga mundësia e njohjes së statusit të punësimit në bazë të nenit 67, pika 4, të këtij ligji, njësia e burimeve njerëzore e ka futur në procedurë konkurrimi këtë pozicion pune. Pas kryerjes ë procedurave të konkurrimit, me Vendimin nr.25/2, datë 27.03.2014, të Kryetarit të Këshillit të Qarkut, "*Për emërim në detyrë*", është emëruar "*Drejtor i Drejtorisë së Mjedisit*". Me aktin nr. 480/1/8, datë 08.05.2014, të Kryetarit të Qarkut Fier, është deklaruar statusi i punësimit në kategorinë "*nëpunës civil në periudhë prove*". Pas përfundimit të periudhës së provës, me aktin nr. 367, datë 30.03.2015, është konfirmuar në kategorinë "*nëpunës civil*".

Pas ristrukturimit, me Vendimin nr.32, dt.19.03.2015, për shkak të shkurtimeve të pozicionit të tij të punës, e kanë kaluar në pozicionin "*Specialist i INU*", pranë Drejtorisë së Menaxhimit të Burimeve Njerëzore, detyrë të cilën ai e ka pranuar dhe vijon ta kryejë.

6. ***** , me Vendimin nr.18, datë 08.01.2014, të Kryetarit të Këshillit të Qarkut, është emëruar "*Drejtor në Drejtorinë Juridike dhe Marrëdhëniet me Jashtë*" dhe më pas, ky pozicion pune është shpallur për konkurrim dhe punonjësi ka marrë pjesë dhe ka fituar, duke u emëruar me aktin nr. 40, datë 31.03.2014 "*Për emërim në detyrë*", në pozicionin e punës në nivelin Drejtor Drejtorie.

Rezulton se me aktin nr. 480/1/5, datë 08.05.2014 është deklaruar statusi i punësimit “*nëpunës civil në periudhë prove*” dhe me aktin nr.382, datë 01.04.2015, i është konfirmuar statusi i nëpunësit civil.

Pas kryerjes së ristrukturimit, “*Drejtoria Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë*” është shkriur dhe funksionet e saj janë bashkuar me Drejtorinë e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore.

Për këtë arsye, ky punonjës, me vendimin nr. 35, dt.19.03.2015, të Kryetarit të Këshillit të Qarkut dhe me pëlqimin e tij, është transferuar në pozicionin “*Jurist*” pranë “*Drejtorisë së Menaxhimit të Burimeve Njerëzore*”.

Edhe për këtë rast, vlen vërejtja e mësipërme për njësinë e burimeve njerëzore, pasi duke u nisur nga momenti i punësimit, që përkon me një datë para fillimit të efekteve juridike të ligjit, punonjësi në fjalë, mund të përfitonte nga dispozita e nenit 67 pika 4 e ligjit nr.152/2013 “*Për nëpunësin civil*” (i ndryshuar), pa qënë nevoja të kryente procesin e konkurrimit. Ky rast nuk është menaxhuar siç duhet nga organi kompetent, por meqënëse veprimet administrative të kryera, nuk çenojnë marrëdhënien e punësimit, evidentohen parregullsitë për të tërhequr vëmendjen e njësisë së burimeve njerëzore, që në të ardhmen, të tregojnë kujdes për një kuptim dhe zbatim të drejtë të dispozitave ligjore.

7. ***** , ka filluar marrëdhënien e punës me Urdhrin nr.31, datë 20.11.2013, të Kryetarit të Këshillit të Qarkut, “*Për emërim në detyrë*”, në pozicionin “*Drejtor Finance*”. Pas konkurrimit, me Vendimin nr.31/2, datë 08.01.2014, të Kryetarit të Këshillit të Qarkut, është emëruar “*Drejtor në Drejtorinë Ekonomike dhe të Shërbimeve*”. Me aktin nr. 480/1/13, datë 08.05.2014, me të drejtë është deklaruar statusi i punësimit në kategorinë “*nëpunës civil në periudhë prove*”. Pas përfundimit të periudhës së provës, me aktin nr. 147/1, datë 10.02.2015 është konfirmuar në kategorinë “*nëpunës civil*”. Duke krahasuar pozicionin e tij në strukturën e vjetër, konstatohet se, emërimi i nëpunësit në fjalë, në pozicionin Drejtor i “*Drejtorisë Ekonomike dhe e Shërbimeve*”, ka ardhur si rezultat i shkriurjes së “*Drejtorisë së Financës*” me “*Drejtorinë e Shërbimeve Rajonale*”.
8. ***** , është emëruar pas fillimit të efekteve të ligjit nr.152/2013, “*Për nëpunësin Civil*”, në pozicionin “*Specialist në Drejtorinë e Shërbimeve Rajonale*” me Urdhërin nr.41/1, datë 17.03.2014, të Kryetarit të Këshillit të Qarkut. Nga krahasimi i pozicionit të tij të punës, konstatohet se ky punonjës është transferuar në pozicionin “*Përgjegjës për Shërbimet dhe Transportin*”, në Drejtorinë Ekonomike dhe Shërbimeve. Marrëdhënia e punës për këtë punonjës është lidhur në kundërshtim me kërkesat e ligjit, pasi në kohën që ka dalë akti i emërimit, kishin filluar efektet e ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*” (i ndryshuar), prandaj akti i emërimit të tij, në kundërshtim me procedurën e parashikuar në nenet 22 e vijues të ligjit në fjalë, në bazë të nenit 23, pika 4, të po këtij ligji, është absolutisht i pavlefshëm. Po kështu, i paligjshëm është dhe sistemimi i tij, pas ristrukturimit, në pozicionin që mban aktualisht “*Përgjegjës për shërbimet dhe transportin*”. Për rregullimin e gjendjes, duhet të vendoset ndërprerja e marrëdhënies së punës për këtë punonjës dhe pozicioni i punës të shpallet i lirë për konkurrim, sipas procedurës së parashikuar nga nenet 22, e vijues të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, (i ndryshuar).
9. ***** , me Urdhërin nr.34, datë 17.03.2014, të Kryetarit të Këshillit të Qarkut, është emëruar “*Specialist në Drejtorinë e Përkujdesjes Sociale*”, në vend të punonjës

*****, e cila ishte me leje lindjeje. Rezulton se me Urdhrin nr.51/2, datë 24.04.2014, të Kryetarit të Këshillit të Qarkut Fier, kalon “*Specialiste në Drejtorinë e Mjedisit*”.

Pas ristrukturimit të institucionit, me “*Vendim Transferimi*” nr.34, datë 19.03.2015, kalon “*Specialiste në Drejtorinë Ekonomike dhe të Shërbimeve*”.

Duke analizuar këtë rast, konstatohet se marrëdhënia e punës edhe për këtë punonjëse është lidhur në kundërshtim me kërkesat e ligjit. Në kohën që ka dalë akti i emërimit, kishin filluar efektet e ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”(i ndryshuar), prandaj akti i emërimit të saj, duke mos respektuar procedurën e parashikuar në nenet 22 e vijues të ligjit në fjalë, në bazë të nenit 23, pika 4, të po këtij ligji, është absolutisht i pavlefshëm. Po kështu, i paligjshëm është dhe sistemimi i saj, pas ristrukturimit, në pozicionin që mban aktualisht, “*Specialiste në Drejtorinë Ekonomike dhe të Shërbimeve*”. Për rregullimin e gjendjes, duhet të vendoset ndërprerja e marrëdhënies së punës për këtë punonjëse dhe pozicioni i punës të shpallet i lirë për konkurrim, sipas procedurës së parashikuar nga nenet 22, e vijues të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, (i ndryshuar).

10. ***** , pas kryerjes të procedurës së konkurimit, me Vendimin nr.3/2, datë 02.02.2014, të Kryetarit të Këshillit të Qarkut, është emëruar “*Specialiste në Drejtorinë e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore*”. Me aktin nr. 480/1/4, datë 08.05.2014 është deklaruar statusi i punësimit në kategorinë “*nëpunëse civile në periudhë prove*”. Pas përfundimit të periudhës së provës, me aktin nr.148, datë 10.02.2015 është konfirmuar “*nëpunëse civile*” në pozicionin “*Specialiste në Drejtorinë e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore*”. Pas ristrukturimit të institucionit, kjo punonjëse ka kaluar në pozicionin “*Specialiste Finance*” në Drejtorinë Ekonomike dhe Shërbimeve, detyrë të cilën e ka pranuar dhe vijon ta mbajë. Edhe në trajtimin e këtij rasti, vlen vërejtja e mëposhtme për njësinë e burimeve njerëzore, pasi punonjësja në fjalë, mund të përfitonte nga dispozita e nenit 67, pika 4, të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, (i ndryshuar) dhe nuk ishte i nevojshëm kryerja e konkurimit. Ky rast nuk është menaxhuar siç duhet nga organi kompetent, por meqenëse veprimet administrative të kryera nuk çenojnë marrëdhënien e punës, evidentohen në material për të tërhequr vëmendjen e njësisë së menaxhimit të burimeve njerëzore, që në të ardhmen të tregojnë kujdes për një kuptim dhe zbatim të drejtë të dispozitave ligjore.
11. ***** , me Vendimin nr.664/2, datë 06.08.2012, të Kryetarit të Këshillit të Qarkut, është emëruar “*Drejtoreshë në Drejtorinë e Turizmit*”. Me aktin nr.480/1/41, datë 08.05.2014, me të drejtë nga njësia e burimeve njerëzore, është deklaruar statusi i saj i punësimit “*nëpunëse civile*” në të njëjtin pozicion. Meqenëse pas ristrukturimit, drejtoria ku bënte pjesë është shkrirë, me Vendimin nr.30, datë 19.03.2015, të Kryetarit të Këshillit të Qarkut, punonjësja ka kaluar “*Specialiste në Drejtorinë Ekonomike dhe të Shërbimeve*”. Aktualisht, kjo nëpunëse është larguar nga kjo detyrë me dorëheqje, e cila është miratuar me Vendimin nr. 584, datë 21.05.2015, “*Për lirim nga shërbimi civil*”, arsye për të cilën ky pozicion është i lirë në strukturën aktuale të Këshillit të Qarkut Fier dhe duhet të plotësohet nëpërmjet procedurës së konkurimit.
12. ***** , ka filluar marrëdhënien me institucionin me Urdhërin nr.137, datë 13.02.2014, të Kryetarit të Këshillit të Qarkut, në pozicionin “*Drejtor në Drejtorinë e Program Zhvillimit Rajonal*”. Rezulton se edhe në këtë rast është aplikuar procedura e

konkurrimit. Edhe pse ky rast duhej trajtuar në bazë të nenit 67, pika 4, të ligjit nr.152/2013, "Për nëpunësin civil" (i ndryshuar) dhe nuk ishte e nevojshme të aplikohet procedura e konkurrimit. Megjithatë, ky është një veprim administrativ që nuk çënon thelbin e marrëdhënies së punës, prandaj nënvizohet si një gabim i njësisë të burimeve njerëzore, për tu patur parasysh në punën e saj në të ardhmen. Punonjësi në fjalë, pasi ka kryer konkurrimin, është emëruar po në këtë detyrë, me Vendimin nr.137/6, datë 27.03.2014, të Kryetarit të Këshillit të Qarkut. Me aktin nr. 480/1/14, datë 08.05.2014 nga ana e njësisë së burimeve njerëzore është deklaruar statusi i punësimit në kategorinë "nëpunës civil në periudhë prove". Pas përfundimit të periudhës së provës, me aktin nr.368, datë 30.03.2015 është konfirmuar "nëpunës civil". Në strukturën aktuale drejtoria ku ishte emëruar, pas riorganizimit të institucionit, ka ndryshuar emërtimin në "Drejtori e Program Zhvillimit, Urbanistikës dhe Planifikimit të Territorit" dhe nëpunësi në fjalë ka mbetur në pozicionin "Drejtor" i kësaj drejtorie .

13. ***** , pas procedurës së konkurrimit, me Vendimin nr.60, datë 01.12.2006, të Kryetarit të Këshillit të Qarkut, është emëruar në pozicionin "Specialist në Drejtorinë e Program Zhvillimit". Me aktin nr.839/1, datë 31.12.2007 është konfirmuar nëpunës civil në pozicionin e mësipërm. Njësia përgjegjëse ka nxjerrë aktin e deklaramit të statusit të punësimit në këtë pozicion, me nr.480/1/20 datë 08.05.2014, në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 152/2013, "Për nëpunësin civil" (i ndryshuar), për këtë punonjëse, duke e rikonfirmuar si nëpunëse civile.

Me anë të shkresës "Njoftim" nr.825 prot., datë 29.07.2015, të Drejtorisë së Menaxhimit të Burimeve Njerëzore të Këshillit të Qarkut Fier, në mbështetje të ligjit nr.152/2013, "Për Nëpunësin Civil"(i ndryshuar), neni 37 "Të drejtat politike", pika 3, neni 54 "Pezullimi për shkak të ligjit", neni 55 "Pezullimi me kërkesë të nëpunësit" dhe neni 56 "Efektet e pezullimit", është kërkuar pezullimi nga detyra i nëpunësit.

Të drejtën e kandidimit për anëtar në këshillat bashkiak e gëzon çdo nëpunës civil bazuar në ligjin nr. 152/2013, "Për nëpunësin civil", (i ndryshuar), pasi në nenin 37, pika 3 të tij theksohet: "Nëpunësi civil ka të drejtën të kandidojë dhe të zgjidhet në zgjedhjet për Kuvendin e Republikës së Shqipërisë, apo për organet e qeverisjes vendore. **Në këtë rast, nëpunësi detyrohet të kërkojë pezullimin nga detyra**".

Në rastin që po analizojmë, rezulton se megjithë njoftimin nga njësia përgjegjëse dhe në kundërshtim me dispozitat e ligjit nr.152/2013, "Për nëpunësin civil" (i ndryshuar), punonjësja vazhdon të ushtrojë funksionin "Specialist në Drejtorinë e Program Zhvillimit", pranë Këshillit të Qarkut Fier, kjo edhe pas shpërndarjes së mandateve për Këshillat Bashkiake, ku kjo punonjëse rezultoi fituese. Ky fakt vërtetohet nga "Proces verbali" nr.2399/4 prot., datë 23.07.2015, i mbajtur pranë Këshillit Bashkiak Fier.

Kjo gjendje, vlerësohet se vjen në kundërshtim me ligjin (neni 54, pika "d" i ligjit nr. 152/2013, "Për nëpunësin civil"(i ndryshuar) dhe duhet të rregullohet menjëherë, duke urdhëruar zbatimin e institutit të pezullimit, për gjithë kohën që do të ushtrojë detyrën e anëtares së këshillit bashkiak.

Me përfundimin e mandatit, në bazë të nenit 56 pika 1, të ligjit nr. 152/2013, "Për nëpunësin civil"(i ndryshuar), kjo punonjëse duhet të kthehet në pozicionin e mëparshëm të punës, ose në rast se pozicioni i punës është i plotësuar përfundimisht, ajo duhet të transferohet në një pozicion tjetër të të njëjtës kategori, ose në pamundësi do të rregjistrohet në listë, e cila administrohet nga njësia përgjegjëse, deri në momentin e sistemimit përfundimtar.

Pozicioni i punës “*Specialist në Drejtorinë e Program Zhvillimit*”, nëse nevojat e institucionit nuk e mundësojnë ruajtjen e tij deri në fund të mandatit të punonjësës në fjalë, mund të shpallet si pozicion i lirë dhe plotësimi i tij, të bëhet nëpërmjet procedurës së konkurrimit, të përcaktuar në nenet 22 dhe 23, të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar dhe Vendimit nr. 243, datë 18.03.2015, të Këshillit të Ministrave, “*Për pranimin, lëvizjen paralele, periudhën e provës dhe emërimin në kategorinë ekzekutive*”. Në këtë rast, pas përfundimit të mandatit, punonjësja do t'i realizojë të drejtat e saj në përputhje me dispozitat që i analizuam më sipër.

14. ******, është emëruar në detyrë pas kryerjes së procedurës së konkurrimit me Vendimin nr.5, datë 04.02.2009, të Kryetarit të Këshillit të Qarkut, në pozicionin “*Specialiste në Drejtorinë e Program Zhvillimit*”. Në përfundim të periudhës së provës, me aktin nr.102, datë 09.02.2009, është konfirmuar nëpunës civil në atë pozicion dhe me aktin nr.480/1/21, datë 08.05.2014 “*Deklarimi i Statusit*”, njësia përgjegjëse ka bërë deklarin e statusit të punësimit, si nëpunëse civile, në pozicionin “*Specialiste në Drejtorinë e Program Zhvillimit*”, të cilin e mban dhe aktualisht, pas ristrukturimit.
15. ******, ka filluar marrëdhënien me institucionin me Vendimin nr.16, datë 01.02.2001, të Kryetarit të Këshillit të Qarkut, në pozicionin “*Drejtoreshë në Drejtorinë e Planifikimit dhe Kontrollit Urban*”. Në përfundim të periudhës së provës, me aktin nr.16/2, datë 01.02.2002 është konfirmuar nëpunëse civile në pozicionin e mësipërm. Pas fillimit të efekteve të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*” (i ndryshuar), njësia përgjegjëse ka nxjerrë aktin e deklarinimit të statusit nr. 480/1/23 datë 08.05.2014, për këtë punonjëse, duke e konfirmuar si nëpunëse civile në pozicionin “*Drejtoreshë në Drejtorinë e Planifikimit dhe Kontrollit Urban*”.
Si pasojë e ristrukturimit dhe shkrirjes së drejtorisë ku figuronte e emëruar kjo punonjëse, me vendimin nr.48, datë 29.06.2015, të Kryetarit të Këshillit të Qarkut, ka kaluar në pozicionin “*Përgjegjëse e Zyrës së Urbanistikës dhe Planifikimit të Territorit*” në “*Drejtorinë e Program Zhvillimit, Urbanistikës dhe Planifikimit të Territorit*”.
16. ******, ka filluar marrëdhënien e punës në institucionin e Këshillit të Qarkut Fier, me Urdhrin nr. 69, datë 21.07.2014, duke mos pa respektuar procedurën ligjore të konkurrimit, në pozicionin “*Drejtoreshë në Drejtorinë e Përkujdesjes Sociale*”. Pas ristrukturimit, drejtoresha ku ishte punësuar ky nëpunës nuk ekziston më dhe pavarësisht se punësimi i tij ishte i parregullt, është mbajtur në punë dhe me Vendimin nr.37, datë 19.03.2015, është transferuar në pozicionin “*Specialist në Drejtorinë e Program Zhvillimit, Urbanistikës dhe Planifikimit të Territorit*”. Edhe nga analiza e këtij rasti, konstatohet që kjo marrëdhënie pune është lidhur në kundërshtim me kërkesat e ligjit. Në kohën që ka dalë akti i emërimit nr.69, datë 21.07.2014, kishin filluar efektet e ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, (i ndryshuar), prandaj ky akt, i cili ka dalë pa respektuar procedurën e konkurrimit, parashikuar në nenet 22 e vijues të ligjit në fjalë, në bazë të nenit 23, pika 4, të po këtij ligji, është absolutisht i pavlefshëm. Po kështu, i paligjshëm është dhe sistemimi i tij, pas ristrukturimit, në pozicionin që mban aktualisht, “*Specialist në Drejtorinë e Program Zhvillimit, Urbanistikës dhe Planifikimit të Territorit*”. Për rregullimin e gjendjes, duhet të vendoset ndërprerja e marrëdhënies së punës ekzistuese dhe pozicioni të shpallet i lirë për konkurrim, sipas procedurës së parashikuar nga nenet 22, e vijues të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, (i ndryshuar).

17. *****, është emëruar në detyrë, pas kryerjes së procedurës së konkurrimit, me Vendimin nr.11, datë 11.04.2011, të Kryetarit të Këshillit të Qarkut, në pozicionin “Specialiste” në Drejtorinë e Përkujdesjes Sociale. Njësia përgjegjëse ka nxjerrë aktin nr.480/1/30 datë 08.05.2014, për deklarimit të statusit të punësimit, në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil” (i ndryshuar), për këtë punonjëse, duke e konfirmuar si nëpunëse civile si “Specialiste” në pozicionin e mësipërm.
- Aktualisht kjo punonjëse është me lejen e lindjes, por e papozicionuar në strukturën e re dhe me kthimin nga leja e lindjes, për njësinë përgjegjëse lind detyrimi për trajtimin e rastit të saj, duke i dhënë një nga zgjidhjet që parashikon legjislacioni në fuqi.

Konkluzione:

1. Në përmbledhje të gjithë sa është thënë më sipër, Komisioneri vëren se nga ana e njësisë përgjegjëse, nuk janë nxjerrë akte të transferimit për të gjithë nëpunësit civilë, të cilët janë pjesë e strukturës së re. Një veprim i tillë, justifikohet nga ana e njësisë së burimeve njerëzore se, këta punonjës të cilëve nuk u është bërë riemërimi, apo transferimi, në pozicionin e ri, pas ristrukturimit, vazhdojnë të ushtrojnë funksionet e tyre, në pozicione të ngjashme me ato të strukturës së vjetër të institucionit. Por, në vetvete mungesa e akteve të transferimit për gjithë këto raste, vjen në kundërshtim me dispozitat e Kreut III, të Vendimit nr. 171, datë 26.3.2014, “Për transferimin e përhershëm dhe të përkohshëm të nëpunësve civilë, pezullimin dhe lirin nga shërbimi civil”, të Këshillit të Ministrave, pika 20, në të cilin thuhet shprehimisht: “Njësia përgjegjëse, brenda 10 (dhjetë) ditëve nga data e marrjes së propozimit nga komisioni i ristrukturimit, vendos për transferimin e nëpunësit civil, njofton nëpunësin civil për vendimin dhe merr mendimin e tij me shkrim...”.

Për rregullimin e situatës së mësipërme, njësia përgjegjëse duhet të nxjerrë aktet e riemërimit pas ristrukturimit, për punonjësit:

- *****, në pozicionin “Drejtor i Drejtorisë së Menaxhimit të Burimeve Njerëzore”;
 - *****, në pozicionin “Specialist në Drejtorinë e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore”;
 - *****, në pozicionin “Drejtori i Drejtorisë së Program Zhvillimit, Urbanistikës dhe Planifikimit të Territorit”;
 - *****, në pozicionin “Specialist në Drejtorinë e Program Zhvillimit, Urbanistikës dhe Planifikimit të Territorit”;
 - *****, në pozicionin “Specialist në Drejtorinë e Program Zhvillimit, Urbanistikës dhe Planifikimit të Territorit”;
 - *****, në pozicionin “Drejtor në Drejtorinë Ekonomike dhe e Shërbimeve”;
 - *****, në pozicionin “Specialist Finance, në Drejtorinë Ekonomike dhe e Shërbimeve”.
2. Për punonjësit, *****, *****, dhe *****, në kushtet kur punësimi i tyre, është bërë me akte të përkohshme emërimi, me pretendimin se janë plotësuar për nevoja emergjente të punës së institucionit, duke mos respektuar procedurën e përcaktuar në ligj, në bazë të nenit 23, pika 4, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, këto akte janë absolutisht të pavlefshme dhe si të tilla, ato nuk mund të prodhojnë pasoja juridike

që në momentin e daljes së tyre, ç`ka do të thotë se, që këta punonjës nuk e kanë fituar statusin e nëpunësit civil dhe si rrjedhim, institucioni nuk ka asnjë detyrim ligjor për t`i sistemuar pas ristrukturimit.

Marrëdhënia e tyre e punës për pozicionet që mbajnë aktualisht, duhet të zgjidhet dhe pozicionet respektive të punës duhet të konsiderohen të lira. Këto pozicione do të plotësohen sipas ligjit, duke respektuar fillimisht të drejtën e sistemimit të nëpunësve të liruar nga shërbimi civil, për shkak të shkurtimit apo riorganizimit të vendit të punës e që e përfitojnë këtë të drejtë për shkak të ligjit.

Nëse Komisioni i Ristrukturimit arrin në përfundimin se asnjë prej punonjësve që kanë dalë të tepërt pas ristrukturimit, nuk plotësojnë kërkesat e përgjithshme, apo të posaçme për t`u emëruar në këto pozicione që lirohen, atëherë do të hapet procedura e konkurrimit sipas kërkesave të nenit 22, e vijues të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, (i ndryshuar).

c. Nëpunës civilë të liruar nga detyra, pas procesit të ristrukturimit.

Në këtë rubrikë do të paraqesim rastet e punonjësve që janë liruar nga shërbimi civil, për shkak të ristrukturimit:

1. ******, me aktin nr.480/1/16, datë 08.05.2014 ka fituar statusin ”Nëpunës civil në periudhë prove” në nivelin ekzekutiv.
Kjo punonjëse është emëruar me Vendimin nr.17, datë 01.07.2012, të Kryetarit të Këshillit të Qarkut, në pozicionin “Specialist në Drejtorinë Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë”. Me Vendimin nr.11, datë 15.03.2013, të Kryetarit të Këshillit të Qarkut, “Për lëvizje paralele”, ka kaluar “Specialist në Drejtorinë e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore”. Nga muaji Prill 2013 – Maj 2014 ka qenë me “Leje Lindje”. Fillimi i efekteve të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil” (i ndryshuar), e ka gjetur në marrëdhënie pune në një pozicion të shërbimit civil, prandaj pavarësisht faktit se praktikisht, në datën 26.02.2014, ajo vazhdonte lejen e lindjes, ka fituar statusin e nëpunësit civil për shkak të ligjit, (neni 67 pika 3), ç`ka me të drejtë është mbajtur parasysh nga njësia e burimeve njerëzore. Pas kthimit nga leja e lindjes, në zbatim të strukturës së miratuar me vendimin nr. 4, dt. 07.02.2014, të Këshillit të Qarkut Fier, për shkak të shkurtimit të vendit të saj të punës, me Vendimin nr. 24, datë 04.07.2014, të Kryetarit të Këshillit të Qarkut, është liruar nga shërbimi civil.
2. ******, ka filluar marrëdhënien e punës në Këshillin e Qarkut Fier, pasi ka kryer procedurën e konkurrimit dhe me Vendimin nr.14, datë 16.06.2012 është emëruar në pozicionin “Specialist” në Drejtorinë e Programim Zhvillimit Rajonal. Me fillimin e efekteve të ligjit 152/2013, ”Për nëpunësin civil”(i ndryshuara), me aktin nr. 480/1/22, datë 08.05.2014, njësia e burimeve njerëzore i ka deklaruar statusin e punësimit në pozicionin e mësipërm, nëpunëse civile në nivelin ekzekutiv.
Pas implementimit të strukturës së fundit, me Vendimin nr. 2, dt. 15.01.2015, të Kryetarit të Këshillit të Qarkut Fier, drejtoria ku ajo bënte pjesë është bashkuar me Drejtorinë e Urbanistikës dhe Planifikimit të Territorit, duke shënuar në këtë mënyrë shkurtimin e shumë pozicioneve të punës, ndërmjet të tjerave edhe të kësaj punonjëseje. Për këtë shkak, me Vendimin nr.225, datë 02.03.2015, të Kryetarit të Këshillit të Qarkut, është

vendosur lirimi nga shërbimi civil, pasi eksperiencia e saj në punë ishte më e vogël, se e disa nëpunësve të tjerë, të cilët u mbajtën pas ristrukturimit.

3. ******, ka filluar marrëdhënien e punës në Këshillin e Qarkut Fier, pas kryerjes të procedurës së konkurrimit, me Vendimin nr.139/6, datë 17.03.2014, të Kryetarit të Këshillit të Qarkut, në pozicionin "*Specialist*" në Drejtorinë e Programim Zhvillimit Rajonal. Ne kuadër të implementimit të strukturës së miratuar me Vendimin nr. 2, datë 15.01.2015, të Këshillit të Qarkut Fier, me Vendimin nr.232, datë 02.03.2015, të Kryetarit të Këshillit të Qarkut, largohet nga shërbimi civil "*Për suprimim të vendit të punës*", pasi me strukturën e re drejtoria ku ai bënte pjesë është shkrirë.
4. ******, është emëruar pas kryerjes së procedurës së konkurrimit, me Vendimin nr. 7, datë 10.03.2011, të Kryetarit të Këshillit të Qarkut Fier, në pozicionin "*Specialist*" në Drejtorinë e Ambientit. Me fillimin e efekteve të ligjit nr.152/2013, "*Për nëpunësin civil*" (i ndryshuar) me të drejtë nga njësia e burimeve njerëzore, është përpiluar akti i deklaramit të statusit të punësimit nr. 480/1/48, datë 08.05.2014, sipas të cilit nëpunësja në fjalë ka fituar statusin e nëpunësit civil në nivelin ekzekutiv. Ne kuadër të implementimit të strukturës së miratuar me vendimin nr. 2, datë 15.01.2015, të Këshillit të Qarkut Fier, me aktin nr. 5, datë 02.03.2015, të Kryetarit të Këshillit të Qarkut, lirohet nga shërbimi civil "*Për shkak të shkurtimeve të vendit të punës*", pasi me strukturën e re drejtoria ku ajo bënte pjesë nuk ekziston më.
5. ******, ka filluar marrëdhënien e punës me institucionin me Urdhrin nr.14, datë 03.09.2008, të Kryetarit të Këshillit të Qarkut Fier, në pozicionin "*Specialist*". Më pas, ka marrë pjesë në procedurën e konkurimit të zhvilluar për pozicionin e punës dhe me aktin nr.17, datë 10.01.2010, të Kryetarit të Këshillit të Qarkut, është emëruar "*Specialiste në Drejtorinë Juridike*". Në vijim, në kuadër të riorganizimit të institucionit me Vendimin nr. 8, datë 10.03.2011, të Kryetarit të Këshillit të Qarkut, ka kaluar "*Specialiste*" në Drejtorinë e Ambientit. Në këtë pozicion e gjeti edhe fillimi i efekteve të ligjit nr.52/2013, "*Për nëpunësin civil*" (i ndryshuar), prandaj njësia e burimeve njerëzore me aktin nr. 480/1/46, datë 08.05.2014 ka deklaruar statusin e saj të punësimit, nëpunëse civile në nivelin ekzekutiv. Pas zbatimit të strukturës së re, të miratuar me vendimin nr. 2 dt. 15.01.2015, të Këshillit të Qarkut Fier, me aktin nr.410, datë 07.04.2015, lirohet nga shërbimi civil "*Për shkak të shkurtimeve të vendit të punës*", pasi me strukturën e re drejtoria ku ajo bënte pjesë nuk ekziston më.
6. ******, ka filluar marrëdhënien e punës me institucionin, me Urdhrin e Komandimit nr.851/1, datë 15.11.2013, të Kryetarit të Këshillit të Qarkut Fier. Më pas janë kryer procedurat e konkurrimit dhe me aktin nr.15/4, datë 08.01.2014, të Kryetarit të Këshillit të Qarkut, është bërë emërimi i tij në pozicionin "*Specialist*", në peirudhë prove, në Drejtorinë e Ambientit. Me fillimin e efekteve të ligjit nr. 152/2013, "*Për nëpunësin civil*" (i ndryshuar), njësia e burimeve njerëzore, me aktin nr. 480/1/9, datë 08.05.2014, ka konfirmuar statusin "*Nëpunës civil në periudhë prove*", në pozicionin "*Specialist*" në Drejtorinë e Ambientit. Pas zbatimit të strukturës së fundit të miratuar me Vendimin nr.2, datë 15.01.2015, të Kryetarit të Këshillit të Qarkut Fier, me aktin nr.29, datë 19.02.2015, lirohet nga shërbimi civil "*Për shkak të suprimimit të vendit të punës*", pasi me strukturën e re drejtoria ku ai bënte pjesë nuk ekziston më.

7. *****; është punonjëse e vjetër e këtij institucioni e emëruar në detyrë me Vendimin nr.10, datë 01.02.2001, të Kryetarit të Këshillit të Qarkut Fier, në pozicionin “*Specialiste*” në Drejtorinë e Financës. Si e tillë, me fillimin e efekteve të ligjit nr.152/2013, “*Për nëpunësin civil*” (i ndryshuar), njësia e burimeve njerëzore me aktin nr. 480/1/17, datë 08.05.2014, i ka deklaruar statusin e saj të punësimit, duke e konfirmuar nëpunëse civile në nivelin ekzekutiv. Pas fillimit të zbatimit të strukturës së fundit të miratuar me Vendimin nr 2, datë 15.01.2015, të Kryetarit të Këshillit të Qarkut Fier, është bërë njoftimi nr. 93/12 akti, datë 02.02.2015, “*Për suprimim të vendit të punës*”. Me Vendimin nr.227, datë 02.03.2015, të Kryetarit të Këshillit të Qarkut, është vendosur lirimi i saj nga shërbimi civil.
8. *****; është emëruar pas kryerjes së procedurës së konkurrimit, me Vendimin nr.332/9, datë 07.12.2009, të Kryetarit të Këshillit të Qarkut Fier, në pozicionin “*Specialist*” në Drejtorinë Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë. Fillimi i efekteve të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*” (i ndryshuar), e ka gjetur në të njëjtin pozicion, prandaj me të drejtë njësia e burimeve njerëzore ka nxjerrë aktin e deklarimit të statusit të punësimit nr.480/1/18, datë 08.05.2014, duke i konfirmuar statusin e nëpunësit civil në nivelin ekzekutiv. Në kuadër të zbatimit të strukturës së re, miratuar me Vendimin nr. 2, datë 15.01.2015, të Këshillit të Qarkut Fier, me Vendimin nr. 369, datë 30.03.2015, të Kryetarit të Këshillit të Qarkut, lirohet nga shërbimi civil “*Për suprimim të vendit të punës*”, pasi me strukturën e re, drejtoria ku ai bënte pjesë, është shkrirë.
9. *****; është emëruar në detyrë me aktin e emërimit në shërbimin civil nr.978/5, datë 27.12.2013, të Kryetarit të Këshillit të Qarkut Fier, pas kryerjes së konkurrimit, si “*Specialiste*” në Drejtorinë e Turizmit, pranë Këshillit të Qarkut Fier. Fillimi i efekteve të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*” (i ndryshuar), e ka gjetur në të njëjtin pozicion, pune, por pa plotësuar afatin një vjeçar, prandaj, me të drejtë njësia e burimeve njerëzore, me aktin nr. 480/1/19, datë 08.05.2014, ka konfirmuar statusin e punësimit si nëpunëse civile në periudhë prove, në nivelin ekzekutiv. Në përfundim të periudhës së provës, pas vlerësimit negativ nga eprori direkt, (me aktin nr.151, datë 10.02.2015, “*Për moskonfirmim të statusit të nëpunësit civil*”), është liruar nga detyra, me Vendimin nr.17, datë 02.03.2015 “*Për largim nga shërbimi civil*”.
10. *****; është punonjëse e vjetër, e cila marrëdhënien e punës e ka filluar me Vendimin e emërimit nr.1, datë 01.02.2001, të Kryetarit të Këshillit të Qarkut Fier, në nivelin “*Specialist*” në Drejtorinë e Shërbimeve Rajonale. Në momentin e fillimit të efekteve të ligjit nr. 152/2013 “*Për nëpunësin civil*” (i ndryshuar), kjo punonjëse ka qënë në të njëjtin pozicion, prandaj njësia e burimeve njerëzore, me aktin nr. 480/1/29, datë 08.05.2014, me të drejtë i ka konfirmuar statusin e e punësimit të saj si nëpunëse civile. Më pas në kushtet e zbatimit të strukturës së re, miratuar me Vendimin nr. 2, datë 15.01.2015 të Këshillit të Qarkut Fier, me Vendimin nr.13, datë 02.03.2015 të drejtuesit të institucionit, lirohet nga shërbimi civil për shkak të ristrukturimit.
11. *****; ka filluar marrëdhënien e punës me institucionin me Vendimin nr.17/3, datë 01.11.2007, të Kryetarit të Këshillit të Qarkut Fier, në pozicionin “*Specialist*” në Drejtorinë e Shërbimeve. Meqënëse fillimi i efekteve të ligjit nr. 152/2013, “*Për*

nëpunësin civil” (i ndryshuar), e gjeti në këtë pozicion pune, njësia e burimeve njerëzore, me aktin nr. 480/1/44, datë 08.05.2014, i ka konfirmuar statusin e nëpunësit civil, në nivelin ekzekutiv, në pozicionin *”Specialist në Drejtorinë e Shërbimeve”*. Pas kësaj, për nevoja pune, me Aktin nr.51/1, datë 24.04.2014, transferohet në Drejtorinë e Përkujdesjes Shoqërore, gjë të cilën ai nuk e ka kundërshtuar. Me strukturën e re të miratuar me Vendimin nr. 2, dt. 15.01.2015, të Këshillit të Qarkut Fier, pozicioni i tij i punës është shkurtuar, prandaj me Vendimin nr. 6, datë 02.03.2015, të Kryetarit të Këshillit të Qarkut, është bërë lirimi i tij nga shërbimi civil.

12. *****, është emëruar në pozicionin *”Specialist”* në Drejtorinë e Përkujdesjes Shoqërore pas kryerjes së procedurës së konkurrimit, me Vendimin nr.1, datë 04.01.2008, të Kryetarit të Këshillit të Qarkut Fier. Fillimi i efekteve të ligjit nr. 152/2013, *”Për nëpunësin civil”* (i ndryshuar), e ka gjetur në të njëjtin pozicion, prandaj, me të drejtë njësia e burimeve njerëzore, me aktin nr. 480/1/13, datë 08.05.2014, i ka deklaruar statusin e punësimin, duke i konfirmuar statusin e nëpunësit civil në nivelin ekzekutiv. Me zbatimin e strukturës së re, miratuar me Vendimin nr. 2, datë 15.01.2015, të Këshillit të Qarkut Fier, vendi i tij i punës është shkurtuar, prandaj me Vendimin nr. 223, datë 02.03.2015, të Kryetarit të Këshillit të Qarkut, është vendosur lirimi i tij nga shërbimi civil.
13. *****, e ka filluar marrëdhënien e punës me institucionin, me Vendim nr.8, datë 01.02.2001, të Kryetarit të Këshillit të Qarkut Fier, në pozicionin *”Specialist”* në Drejtorinë e Urbanistikës. Me Vendimin nr.7, datë 01.02.2010, është emëruar *”Specialist”* në Drejtorinë e Përkujdesjes Shoqërore dhe fillimi i efekteve të ligjit nr.152/2013, *”Për nëpunësin civil”* (i ndryshuar), e ka gjetur në këtë pozicion prandaj, me të drejtë njësia e burimeve njerëzore, me aktin nr. 480/1/28, datë 08.05.2014, i ka konfirmuar statusin e punësimin si nëpunëse civile, në nivelin ekzekutiv. Me zbatimin e strukturës së re, miratuar me vendimin nr. 2, datë 15.01.2015, të Kryetarit të Këshillit të Qarkut Fier, vendi i saj i punës është shkurtuar, për këtë shkak, me Vendimin nr. 220, datë 03.03.2015, është urdhëruar lirimi nga shërbimi civil, për shkurtim të vendit të punës. *Punonjësja e ka ankimuar këtë vendim dhe çështja është ende në gjykim.*
14. *****, është emëruar në pozicionin *”Specialist”* në Drejtorinë e Turizmit dhe Kulturës, pas kryerjes së procedurës së konkurrimit, me Vendimin nr.25, datë 14.01.2013, të Kryetarit të Këshillit të Qarkut Fier. Fillimi i efekteve të ligjit nr.152/2013, *”Për nëpunësin civil”* e ka gjetur në të njëjtin pozicion, prandaj, me të drejtë njësia e burimeve njerëzore, me aktin nr. 480/1/42, datë 08.05.2014, i ka konfirmuar statusin e nëpunësit civil, në detyrën e mësipërme, në pozicionin *”Specialist”*.

Me zbatimin e strukturës së re, miratuar me Vendimin nr. 2, datë 15.01.2015, të Kryetarit të Këshillit të Qarkut Fier, vendi i saj i punës është shkurtuar dhe për këtë shkak, me Vendimin nr.333/4, datë 19.03.2015, të Kryetarit të Këshillit të Qarkut Fier, është urdhëruar lirimi nga shërbimi civil, për shkak të shkurtimit të vendit të punës.

15. *****, është emëruar në pozicionin *”Specialist”* në Drejtorinë e Turizmit dhe Kulturës, pas kryerjes së procedurës së konkurrimit, me Vendimin nr.5, datë 16.04.2009, të Kryetarit të Këshillit të Qarkut Fier. Fillimi i efekteve të ligjit nr. 152/2013, *”Për*

nëpunësin civil” (i ndryshuar), e ka gjetur në të njëjtin pozicion, prandaj, me të drejtë njësia e burimeve njerëzore, me aktin nr. 480/1/39, datë 08.05.2014, ka konfirmuar statusin e nëpunësit civil në detyrën e mësipërme, në pozicionin “*Specialist*”.

Me zbatimin e strukturës së re, miratuar me Vendimin nr. 2, datë 15.01.2015, të Kryetarit të Këshillit të Qarkut Fier, vendi i tij i punës është shkurtuar dhe për këtë shkak, me Vendimin nr. 23, datë 20.06.2014, të Kryetarit të Këshillit të Qarkut Fier, është urdhëruar lirimi nga shërbimi civil.

16. *****, ka filluar marrëdhënien e punës me institucionin me kontratë pune, me afat 3 muhor. Pas kësaj ka marrë pjesë në konkurrimit e organizuar dhe pasi është shpallur fituese, është emëruar “*Specialiste*” në Drejtorinë e Planifikimit dhe Kontrollit Urban me Vendimin nr.10, datë 01.04.2011, të Kryetarit të Këshillit të Qarkut Fier.

Fillimi i efekteve të ligjit nr. 152/2013 “*Për nëpunësin civil*” (i ndryshuar), e ka gjetur në të njëjtin pozicion dhe me të drejtë, njësia e burimeve njerëzore, me aktin nr. 480/1/24, datë 08.05.2014, i ka konfirmuar statusin e punësimit si nëpunëse civile në nivelin ekzekutiv. Me zbatimin e strukturës së re, miratuar me Vendimin nr. 2, dt. 15.01.2015, të Këshillit të Qarkut Fier, vendi i saj i punës është shkurtuar e për këtë shkak, lirohet nga shërbimi civil me Vendimin nr.333/2, datë 19.03.2015.

17. *****, është emëruar në pozicionin “*Specialist*” në Drejtorinë e Planifikimit dhe Kontrollit Urban, pas kryerjes të procedurës së konkurrimit, me Vendimin nr.15, datë 07.04.2010, të Kryetarit të Këshillit të Qarkut Fier.

Fillimi i efekteve të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, e ka gjetur në të njëjtin pozicion dhe me të drejtë, njësia e burimeve njerëzore, me aktin nr. 480/1/49, datë 08.05.2014, i ka konfirmuar statusin e punësimit si nëpunës civil në nivelin ekzekutiv. Me zbatimin e strukturës së re, miratuar me Vendimin nr. 2, dt. 15.01.2015, të Këshillit të Qarkut Fier, vendi i tij i punës është shkurtuar, e për këtë shkak lirohet nga shërbimi civil me Vendimin nr.8, datë 02.03.2015.

18. *****, ka filluar marrëdhënien e punës në shërbimin civil pas kryerjes të procedurës së konkurrimit, me aktin e emërimit në shërbimin civil, nr. 331, datë 31.03.2014, të Kryetarit të Këshillit të Qarkut Fier, në pozicionin “*Specialist*” në Drejtorinë e Planifikimit dhe Kontrollit Urban.

Fillimi i efekteve të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*” (i ndryshuar), e ka gjetur në të njëjtin pozicion pune, por pa plotësuar afatin një vjeçar dhe me të drejtë, njësia e burimeve njerëzore, me aktin nr. 480/1/43, datë 08.05.2014, i ka konfirmuar statusin e punësimit si nëpunëse civile në periudhë prove, në nivelin ekzekutiv. Në përfundim të periudhës së provës, pas vlerësimit negativ nga eprori direkt, (me aktin nr.154, datë 10.02.2015, “*Për moskonfirmim të statusit të nëpunësit civil*”), është larguar nga shërbimi civil, me Vendimin nr.192, datë 18.02.2014, “*Për largim nga shërbimi civil*”.

19. *****, ka filluar marrëdhënien e punës me institucionin pas kryerjes të procedurës së konkurrimit, me Vendimin nr.19, datë 04.05.2010, të Kryetarit të Këshillit të Qarkut Fier, në pozicionin “*Specialist*” (Inxhinier topograf) në Drejtorinë e Planifikimit dhe Kontrollit Urban. Me Vendimin nr.2, datë 03.01.2013, “*Për lëvizje paralele*”, të Kryetarit të Këshillit të Qarkut, kalon “*Specialist*” në Njësinë e Auditimit dhe Inspektoriatit të Rrugëve, në Drejtorinë e Planifikimit dhe Kontrollit Urban.

Fillimi i efekteve të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil” (i ndryshuar), e ka gjetur në të njëjtin pozicion dhe me të drejtë, njësia e burimeve njerëzore, me aktin nr. 480/1/45, datë 08.05.2014, i ka konfirmuar statusin e punësimit si nëpunës civil në nivelin ekzekutiv. Me zbatimin e strukturës së re, miratuar me Vendimin nr. 2, dt. 15.01.2015 të Këshillit të Qarkut Fier, vendi i tij i punës është shkurtuar, e për këtë shkak lirohet nga shërbimi civil me Vendimin nr. 25, datë 19.03.2015.

20. ******, ka filluar marrëdhënien e punës me institucionin pas kryerjes së procedurës së konkurrimit, me aktin e emërimit në shërbimin civil, nr.123/1, datë 01.02.2011, të Kryetarit të Këshillit të Qarkut Fier, në pozicionin “*Specialist*” në Inspektoriatin e Ndërtimit dhe Urbanistikës.

Fillimi i efekteve të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil” (i ndryshuar), e ka gjetur në të njëjtin pozicion prandaj, me të drejtë njësia e burimeve njerëzore me aktin nr.480/1/28, datë 08.05.2014, i ka konfirmuar statusin e punësimit si nëpunës civil në nivelin ekzekutiv. Me zbatimin e strukturës së re, miratuar me Vendimin nr. 2, datë 15.01.2015, të Këshillit të Qarkut Fier, vendi i tij i punës është shkurtuar, e për këtë shkak me shkresën nr. 93/21, datë 02.02.2015, është njoftuar fillimisht për suprimimin e vendit të punës, si pasojë e ristrukturimit dhe me aktin nr. 231, datë 02.03.2015, është liruar nga shërbimi civil për këtë shkak.

21. ******, ka filluar marrëdhënien e punës me institucionin, me aktin e emërimit në shërbimin civil nr.13/1, datë 30.06.2007, të Kryetarit të Këshillit të Qarkut Fier, pas kryerjes së procedurës së konkurrimit, në pozicionin “*Kryeinspektor*” në IMT. Fillimi i efekteve të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil” (i ndryshuar), e ka gjetur në të njëjtin pozicion prandaj, me të drejtë njësia e burimeve njerëzore, me aktin nr. 480/1/31, datë 08.05.2014, ka konfirmuar statusin e punësimit si nëpunës civil. Me shkresën nr.93/19, datë 02.02.2015, është njoftuar për suprimim të vendit të punës, si pasojë e ristrukturimit. Lirohet nga shërbimi civil me Vendimin nr.226, datë 02.03.2015, për shkak të suprimimit të vendit të punës.

Konkluzion: Komisioneri vlerëson se, procedura e ndjekur për ristrukturimin e institucionit është realizuar në përputhje me dispozitat e nenit 50, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, (i ndryshuar), si dhe me Kreun III, “*Transferimi për shkak të mbylljes dhe ristrukturimit të institucionit*”, të Vendimit nr. 171, datë 26.3.2014 “*Për transferimin e përhershëm dhe të përkohshëm të nëpunësve civilë, pezullimin dhe lirin nga shërbimi civil*”, të Këshillit të Ministrave.

Nga këqyrja e akteve, Komisioneri vlerëson, se njësia përgjegjëse ka vepruar drejt në ngritjen e Komisionit të Ristrukturimit, në përcaktimin e përbërjes së tij, në respektimin e afatit kohor të ngritjes së tij, si dhe në respektimin e të gjitha procedurave të detyrueshme për tu zbatuar nga ky komision gjatë gjithë fazave të ristrukturimit. Nga ana tjetër, vlerësohet se institucioni ka vepruar drejt, duke njoftuar sipas afatit kohor, një muaj para, të gjithë punonjësit për nisjen e procedurës së ristrukturimit të institucionit dhe të suprimimit të vendit të punës, kjo në referencë të nenit 50, pika 7, e ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar.

Pas kësaj analize, duhet të sjellim në vëmendjen e njësisë së administrimit të burimeve njerëzore, se në raste ristrukturimi, pavarësisht faktit se plotësohen kushtet e tilla si, shkurtim i numrit të

përgjithshëm të vendeve të punës dhe pamundësia për t'i sistemuar në të njëjtin institucion, duhet të tregohet kujdes që të bashkëpunojnë me institucionet e tjera, që janë pjesë e shërbimit civil dhe që kanë pozicione të lira pune, për të siguruar transferimin e punonjësve që kanë dalë të tepërt nga procesi, me qëllim që pagesa sipas vjetërsisë dhe lirimi nga shërbimi civil, të jetë mjeti i fundit, pasi të jenë shteruar të gjitha rrugët e tjera të parashikuara nga ligji për sistemimin e tyre.

III. Procedura dhe formati i përshkrimit të punës

Sipas parashikimeve të nenit 50, të ligjit 152/2013, "Për nëpunësin civil", (i ndryshuar), të Vendimit nr. 142, datë 12.03.2014 "Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura" të Këshillit të Ministrave pika 14 "Procedura dhe formati i përshkrimit të punës", si dhe Vendimit nr.2, datë 15.01.2015, "Për strukturën organizative të Administratës së Këshillit të Qarkut Fier", rezulton se njësia përgjegjëse e Këshillit të Qarkut Fier, ka hartuar përshkrimet e punës në funksion të procesit të ristrukturimit.

Konstatohet se formati i përshkrimit të punës i përmban të gjitha rubrikat e parashikuara në aktet nënligjore që e rregullojnë këtë proces.

Nevoja për përshkrime të reja të punës është diktuar nga ndryshimi i mënyrës së organizimit të Këshillit të Qarkut Fier, si pasojë e ristrukturimit. Në përmbajtjen e tyre, këto akte janë një përmbledhje e misionit, qëllimit të përgjithshëm, detyrave kryesore dhe përgjegjësive kryesore të pozicioneve të reja të punës, në përputhje me detyrat dhe përgjegjësitë e reja.

Pas ristrukturimit, një numër më i reduktuar nëpunësish civilë do të plotësojnë të gjitha detyrimet në funksion të arritjes së misionit për të cilin është krijuar institucioni i këshillit të qarkut e për rrjedhojë, përzgjedhja e tyre ishte e nevojshme të bëhej mbi bazën e kërkesave për një nivel më të lartë profesional, me aftësi të mira organizative dhe menaxhuese, në përputhje me detyrat dhe përgjegjësitë e reja.

Këto rezultojnë se kanë qënë kriteret që janë mbajtur parasysh nga komisioni i ristrukturimit dhe njësia përgjegjëse, në marrjen e vendimeve përfundimtare të emërimit në pozicionet e mbetura pas procesit të ristrukturimit.

IV. Përmbajtja dhe administrimi i dosjeve të personelit dhe Rregjistri i Personelit

Në zbatim të programit dhe drejtimeve të mbikëqyrjes, grupi i punës verifikoi dosjet e personelit dhe rregjistrin e personelit për të parë nëse ato janë krijuar dhe administrohen në përputhje me përcaktimet e nenit 17, të ligjit nr. 152/2013, "Për nëpunësin civil" (i ndryshuar) dhe sipas kërkesave të Vendimit nr. 117, të Këshillit të Ministrave, datë 05.03.2014, "Për përmbajtjen, procedurën dhe administrimin e dosjeve të personelit e të regjistrit qendror të personelit".

Nga këqyrja e akteve të administruara në dosjen individuale të çdo nëpunësi civil, u konstatua se janë të përfshira dokumenta me të dhënat personale të karakterit teknik, profesional, si dhe të dhëna të tjera sipas lidhjes 1 dhe 2, bashkëlidhur Vendimit të Këshillit të Ministrave, që rregullon në mënyrë specifike këtë aspekt.

Konkretisht, rezultoi se në çdo dosje janë të administruara dokumenti i identifikimit (*fotokopje e letërnjoftimit*); dokumenti mbi gjendjen civile (*çertifikata e gjendjes familjare*); dokumentet lidhur me nivelin e edukimit arsimor dhe fushën e studimeve (*fotokopje e diplomës së shkollës së lartë dhe lista e notave*); dokumentet që vertetojnë datën e fillimit të punës në pozicionin përkatës (*akti i emërimit*) etj.

Në përfundim të verifikimeve të kryera konstatojmë se, në dosje nuk mungon asnjë dokument, i kërkuar nga ligji nr. 152/2013 “*Për nëpunësin civil*”, (i ndryshuar), si dhe aktet nënligjore që rregullojnë këtë proces.

Konkluzion: Komisioneri vlerëson se dosjet e personelit janë të sistemuara dhe ruhen në kushte të përshtatshme në ambientet e institucionit dhe administrohen nga Drejtoria e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore dhe ato janë të plotësuara me aktet dhe me dokumentacionin, sipas kërkesave të ligjit nr. 152/2014, “*Për nëpunësin civil*” (i ndryshuar).

KONKLUZION:

Nisur nga parregullsitë e konstatuara, të cilat nuk çenojnë ligjshmërinë në tërësi të procesit të ristrukturimit, sepse mund të konsiderohen si të karakterit objektiv, për shkak të shkurtimit të buxhetit, lind domosdoshmëria e korrigjimit të tyre:

1. Njësia përgjegjëse duhet të drejtojë procesin e revokimit të akteve administrative nga titullari i institucionit, si më poshtë:
 - Urdhrin nr.41/1, datë 17.03.2014, për emërimin e punonjësit ***** në pozicionin “*Specialist në Drejtorinë e Shërbimeve*” dhe të shpallë si të lirë këtë pozicion pune.
 - Urdhrin nr.69, datë 21.07.2014, për emërimin e punonjësit ***** në pozicionin “*Drejtor në Drejtorinë e Përkujdesjes Sociale*”, si dhe akteve për transferim në pozicione të shërbimit civil të nxjerra për këtë punonjës në bazë të Vendimit nr. 2, datë 15.01.2015, të Këshillit të Qarkut Fier, “*Mbi miratimin e strukturës organizative të administratës së Këshillit të Qarkut Fier për vitin 2015*”, sipas rekomandimeve në rubrikën përkatëse në këtë projekt raport.
 - Urdhër Komandimi nr. 34, datë 17.03.2014, për punonjësën ***** në pozicionin “*Specialist në Drejtorinë e Përkujdesjes Sociale*”, si dhe aktet për transferim në pozicione të shërbimit civil të nxjerra për këtë punonjës në bazë të Vendimit nr. 2, datë 15.01.2015, të Këshillit të Qarkut Fier, “*Mbi miratimin e strukturës organizative të administratës së Këshillit të Qarkut Fier për vitin 2015*” sipas rekomandimeve në rubrikën përkatëse në këtë projekt raport.
2. Pozicionet e mësipërme, sipas strukturës aktuale, “*Specialist në Drejtorinë e Programim Zhvillimit, Urbanistikës dhe Planifikimit të Territorit*”, “*Përgjegjës për Shërbimet dhe Transportin, në Drejtorinë Ekonomike dhe Shërbimeve*” dhe “*Specialiste Mjeditë në Drejtorinë Ekonomike dhe të Shërbimeve*”, duhet të shpallen pozicione të lira nga njësia përgjegjëse dhe të plotësohen sipas procedurave përkatëse të parashikuara në ligjin nr.152/2013, “*Për nëpunësin civil*” (i ndryshuar), fillimisht, duke parë mundësinë e plotësimit të tyre nga punonjësit e liruar për shkak të shkurtimit të vendeve të punës dhe

nëse kjo nuk do të jetë e mundur, për mosplotësim të kërkesave, apo kritereve të veçanta të pozicioneve të punës, të kalohet në fazat përkatëse të konkurimit.

3. Nga ana e njësisë përgjegjëse të vlerësohet nëse është e nevojshme për punën, shpallja si vend i lirë i pozicionit “*Specialist*”, në “*Drejtorinë e Administrimit dhe Mbrojtjes së Tokës*”, i liruuar për shkak të ligjit nga nëpunësi ***** dhe të plotësohet sipas procedurave të parashikuara në ligjin nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, (i ndryshuar), si dhe Vendimit nr. 243, datë 18.03.2015, të Këshillit të Ministrave, “*Për pranimin, lëvizjen paralele, periudhën e provës dhe emërimin në kategorinë ekzekutive*”.
4. Te nxirret akti i “*Pezullimit nga shërbimi civil*” për nëpunësen ***** dhe pozicioni i saj i punës “*Specialist në Drejtorinë e Program Zhvillimit*”, pasi të lirohet, duhet të vlerësohet nevoja për plotësimin e tij, nëpërmjet procedurës së konkurrimit, të përcaktuar në nenet 22 dhe 23, të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, (i ndryshuar) dhe Vendimit nr. 243, datë 18.03.2015, të Këshillit të Ministrave, “*Për pranimin, lëvizjen paralele, periudhën e provës dhe emërimin në kategorinë ekzekutive*”.
5. Njësia e burimeve njerëzore duhet t’i ndërpresë periudhën e provës dhe t’i deklarojë statusin e nëpunësit civil të konfirmuar për punonjësen *****, në pozicionin “*Specialiste e INU, në Drejtorinë e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore*”, ku është duke kryer detyrën aktualisht.
6. Njësia përgjegjëse duhet të nxjerrë aktet e transferimit/riemërimit, për punonjësit:
 - *****, në pozicionin “*Drejtor i Drejtorisë së Menaxhimit të Burimeve Njerëzore*”;
 - *****, në pozicionin “*Specialist në Drejtorinë e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore*”;
 - *****, në pozicionin “*Drejtori i Drejtorisë së Program Zhvillimit, Urbanistikës dhe Planifikimit të Territorit*”;
 - *****, në pozicionin “*Specialist në Drejtorinë e Program Zhvillimit, Urbanistikës dhe Planifikimit të Territorit*”;
 - *****, në pozicionin “*Specialist në Drejtorinë e Program Zhvillimit, Urbanistikës dhe Planifikimit të Territorit*”;
 - *****, në pozicionin “*Drejtor në Drejtorinë Ekonomike dhe e Shërbimeve*”;
 - *****, në pozicionin “*Specialist Finance, në Drejtorinë Ekonomike dhe e Shërbimeve*”.

*

* *

Këto ish-in rrethanat e konstatuara nga inspektimi i përgjithshëm, kryer në institucionin e Këshillit të Qarkut Fier, në lidhje me zbatimin e ligjit nr.152/2013 “*Për nëpunësin civil*”, (i ndryshuar), gjatë procesit të administrimit të shërbimit civil.

Aktet administrative që dokumentojnë këtë proces, janë materializuar në tabelat si më poshtë:

Aneksi nr. 1: “Vazhdimësia në shërbimin civil për nëpunësit dhe punonjësit që kryejnë funksione të shërbimit civil, institucioni Këshilli i Qarkut Fier”.

Aneksi nr. 2: “Gjendja e shërbimit civil në momentin e inspektimit. Aktet që materializojnë procesin e njohjes së statusit për nëpunësit që punonin në pozicione të shërbimit civil, në momentin e fillimit të efekteve të ligjit nr. 152/2013 (data 26.02.2014), institucioni Këshillit i Qarkut Fier”.

Aneksi nr. 3: “Respektimi i kërkesave të përgjithshme sipas ligjit dhe i kërkesave të posaçme sipas formularit të përshkrimit të punës, për punonjësit që janë të emëruar aktualisht në pozicione pune pjesë e shërbimit civil, në institucionin, Këshilli i Qarkut Fier”.

KOMISIONERI

Pranvera STRAKOSHA